

Enti Rregullator i Ujit



RAPORTI VJETOR

2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR 2024

VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
DHE
GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS KANALIZIME

Shkurt, 2025

PËRMBAJTJA

Shkurtime	3
Parathënie	4
Përmbledhje	7
1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit	14
1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë.....	14
1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të “Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë”	14
1.3 Struktura Organizative e ERRU-së	15
1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese	16
1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK	16
1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor	19
1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore	22
1.4.4 Mbrojtja e Konsumatorëve.....	23
1.4.5 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK.....	26
1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së	27
1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare	27
1.5.1.1 Me Kuvendin e Shqipërisë.....	27
1.5.1.2 Me AKUK (Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve)	27
1.5.1.2.1 Me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).....	27
1.5.1.3 Me Autoritetin e Konkurrencës.....	28
1.5.1.4 Me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.....	28
1.5.1.5 Me Akademinë e Shkencave	28
1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare	28
1.5.2.1 ERRU, Anëtare e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare	29
1.5.2.2 Bashkëpunimi me Donatorë dhe Aktorë Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë	29
1.5.2.3 Marrëdhëniet Bilaterale.....	30
1.5.2.4 Artikuj Studimorë, Botimet	30
1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median	31
1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së	31
1.7.1 Të Ardhurat	31
1.7.2 Shpenzimet Operative	32
2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për vitin 2024	34
3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi	41
4 Ecuria e Reformës në Sektorin UK sipas VKM Nr. 302, datë 11.05.2022	43
5 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për vitin 2025	45
6 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për vitin 2024	46
Investimet në Sektorin e Ujësjetës Kanalizimeve për vitin 2024	53
Subvencionet për vitin 2024	54
7 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe të Sektorit të Ujit	56
Aneks 1 - Aplikimet e Shoqërive dhe Situata e Licencimit për vitin 2024	57
Aneks 2 - Tarifat për Shërbimin e FU dhe Largimit të UN - viti 2024	59
Aneks 3 - Subvencionet e Shoqërive UK, vitet 2023-2024 (në lekë)	60
Aneks 4 - Mbledhjet dhe Vendimet e KKRR - viti 2024	61
Aneks 5 - Referencat Ligjore të Aktivitetit të ERRU-së	62

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të FU dhe Largimit e Përpunimit të UN
UK	Ujësjiellës Kanalizime
UKR	Ujësjiellës Kanalizime Rajonale
U	Ujësjiellës
UN	Ujërat e Ndotura
FU	Furnizimi me Ujë
KUN	Kanalizimi i Ujërave të Ndotura
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KVPTM	Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
KM	Këshilli i Ministrave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
SHA	Shoqëri Aksionere
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve
IWA	Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
SHUKALB	Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë
SHUKOS	Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Kosovës
WAREG	Shoqata e Rregullatorëve të Ujit të Evropës
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
NER	Rrjeti i Rregullatorëve Ekonomikë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
TKP	Treguesit Kryesorë të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operative dhe Mirëmbajtjeje
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
UPA	Uji Pa të Ardhura
CEI	Nisma e Evropës Qendrore

Parathënie

Raporti Vjetor i aktivitetit të Entit Rregullator të Ujit (ERRU), paraqet aktivitetin dhe performancën e ERRU në përmbushje të detyrimit që e ngarkon ligji dhe që shprehet në veçanti në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2024. Raporti pasqyron gjithashtu zhvillimet kryesore në sektorin ujësjellës kanalizime në Shqipëri dhe jep rekomandime për përmirësimin e performancës së sektorit UK dhe të vetë institucionit.

ERRU, zhvillon prej 27 vitesh aktivitetin si institucion i pavarur për rregullimin e sektorit të ujësjellës kanalizimeve, duke përballuar sfida jo të vogla për forcimin e statusit të tij. Në këtë kontekst, ERRU ka bërë përpjekje maksimale për krijimin e një mjedisi rregullator profesional, ligjor dhe transparent për publikun, duke pasur gjithnjë në fokus rritjen e kapaciteteve në nivele bashkëkohore në mënyrë që të shërbejë për përmirësimin e performancës së këtij sektori jetik, dhe veçanërisht të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, duke pasur në konsideratë përballueshmërinë e faturave nga ana e tyre.

Viti 2024 ka qenë vit i vazhdimësisë së reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, çka ka sjellë një shtim të angazhimit të ERRU-së për të përballuar fluksin e madh të kërkesave për licencim dhe veçanërisht për tarifa të reja për shoqëritë e reja rajonale të krijuara. Procesi i riorganizimit deri në fund të vitit 2024 rezultoi në konkretizimin e 14 shoqërive UK rajonale, nga 15 të parashikuara sipas reformës, pasi akoma nuk është krijuar Shoqëria Rajonale UK Tiranë që përfshin bashkitë: Tiranë, Kamzë dhe Vorë.

Krahas përballimit të një pune mjaft voluminoze, ERRU ka përmirësuar mjaft punën në drejtim të analizave dhe të një vendimmarrjeje të drejtë për tarifën e reja të propozuara nga shoqëritë UK, bazuar në metodologjinë e re të tarifave, e cila imponon ndjekjen e logjikës së një plani biznesi, për të cilin së shpejti, ERRU do të miratojë një dokument të unifikuar, i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjitha shoqëritë UK.

Drejtimet kryesore të aktivitetit të ERRU-së për vitin 2024 janë përqendruar në pikat e mëposhtme:

- Licencimi i shoqërive UK;
- Analiza dhe miratimi i propozimeve për tarifa të reja nga shoqëritë UK;
- Monitorimi i performancës së shoqërive UK;
- Mbrojtja dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve ndaj shoqërive UK;
- Pjesëmarrje aktive fizike dhe online në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Raportime dhe analiza mbi aktivitetin e ERRU, etj.

Gjatë vitit 2024, ERRU ka miratuar licenca për 3 shoqëri UK, nga të cilat 1 shoqëri e re rajonale e krijuar sipas reformës UK Vlorë, duke e çuar në 14 numrin e shoqërive rajonale të krijuara dhe të licencuara, nga 15 që parashikon reforma. Gjithashtu ka miratuar licenca për efekt rinovimi edhe për Shoqërinë Rajonale UK Korçë, si dhe shoqërinë ekzistuese UK Vorë. ***Vlen të theksohet se, në vijim të reformës ndikimi pozitiv i saj në drejtim të kapërcimit të vështirësive që kishin shoqëritë e vogla para reformës është reflektuar edhe në situatën e licencimit të shoqërive UK. Në mbyllje të vitit 2024 rezultojnë me licencë të vlefshme të gjitha shoqëritë UK (17 shoqëri) që operojnë në sektor.***

Për vitin 2024, pranë ERRU-së janë paraqitur aplikime për tarifa të reja nga 6 shoqëri UK rajonale përkatësisht: *UK Pogradec, Gjirokastrë, Shkodër, Korçë, Elbasan dhe Berat*. Deri në mbyllje të vitit 2024, KKRR ka marrë vendim përfundimtar për tarifa për shoqëritë rajonale *UKR Pogradec, Gjirokastrë, Shkodër*, si dhe për tre shoqëri të tjera rajonale *UKR Lezhë, Fier dhe Durrës*, të cilat kishin aplikuar që në shtator të vitit 2023. Ndërkohë, vijojnë të jenë në proces të analizës tekniko-ekonomike 3 shoqëri UK rajonale si: *UKR Korçë, Elbasan dhe Berat*.

Monitorimi i performancës së shoqërive UK vijon të mbetet në fokus kryesor të punës së ERRU-së, sidomos për shoqëritë e reja rajonale që kanë aplikuar për nivel të ri tarifar. Gjatë analizave tekniko-ekonomike janë analizuar treguesit kryesorë të performancës dhe në të njëjtën kohë janë vendosur objektivat që duhen arritur prej tyre në vitet pasardhëse sipas periudhës rregullatore të vendosur për secilën shoqëri. Gjithashtu është ndjekur një politikë komunikimi ndëraktive me shoqëritë UK me qëllim mbështetjen e tyre gjatë procesit të riorganizimit. Si rezultat, janë realizuar takime dhe vizita monitoruese në vend, kryesisht me shoqëritë UK rajonale mbi problematikat e licencimit, nevojës për rishikimin e tarifave, pagesat rregullatore, identifikimin e problematikave në raportimin e të dhënave të sakta dhe të besueshme, identifikimin e rrugëve për përmirësimin e performancës financiare etj.

Mbrojtja e konsumatorit edhe në vitin 2024 ka qenë në fokus të punës së ERRU-së për të siguruar që shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura të jenë të qëndrueshme, të sigurt dhe të përballueshme për konsumatorët, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj tyre. Seancat dëgjimore me publikun gjatë procesit të miratimit të tarifave, monitorimi i vazhdueshëm i treguesve të performancës, përmirësimi i mekanizmave të informimit si dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve kanë qenë pjesë e pandashme e punës së institucionit. Gjithashtu, ERRU ka kontribuar edhe në dokumentin strategjik sipas VKM nr. 326, datë 29.05.2024 “Për Miratimin e Strategjisë Ndër sektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030” në zbatim edhe të direktivave evropiane si dhe në dokumentin “Zgjidhja Alternative të Mosmarrëveshjeve”, në kuadër të harmonizimit me Direktivën 2013/11/EU të Parlamentit Evropian si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për nën kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit” pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) të Bashkimit Evropian.

ERRU ka vijuar të konsiderojë si prioritet të veprimtarisë së tij bashkëpunimin me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës, përkatësisht me Kuvendin e Shqipërisë, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë përmes AKUK, me AMBU, me Autoritetin e Konkurrencës si dhe me donatorët dhe shoqatat, duke qenë pjesë aktive në konferenca dhe seminare të ndryshme.

Gjithashtu ERRU, ka vijuar ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet partnere të rajonit dhe Evropës duke qenë aktive në diskutime dhe duke dhënë kontributin dhe eksperiencën, veçanërisht si pjesë e task forcave që krijohen për studime dhe raporte për çështje të ndryshme të aktiviteteve të rregullatorëve ekonomikë. Baza e këtyre shkëmbimeve mbeten bashkëpunimi i frytshëm me WAREG (Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit), ku ERRU është anëtare me të drejta të plota. Në vijim të këtij bashkëpunimi, ERRU është përfshirë në dy projekte: Programi *TAIEX i Komisionit Evropian*, që ofron asistencë teknike për institucionet publike në lidhje me përafrimin, aplikimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE për ujërat, si dhe ai i financuar nga *CEI* për ngritjen e kapaciteteve të stafeve rregullatore. Gjithashtu bashkëpunimet kanë vijuar edhe me Bankën Botërore

si financuese e projektit për modernizimin e sektorit UK, ku ERRU dhe AKUK po vijnë me zbatimin e dy marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara në nëntor të vitit 2023 mbi “Raportimin e të Dhënave të Shoqërive UK pranë Sistemit të Integruar të Informacionit të Performancës (IPIS)”, si dhe marrëveshja mbi “Hartimin dhe Miratimin e Modelit të Planeve Pesëvjeçare të Biznesit për Shërbimet e FU dhe KUN”. Më tej, bashkëpunimet kanë vijuar me IWA (Shoqata Ndërkombëtare e Ujit), si dhe marrëdhëniet dypalëshe me rregullatorët në rajon, si: Kosova, Maqedonia dhe Mal i Zi. Këto bashkëpunime kanë dhënë ndikim pozitiv në ngritjen profesionale të stafit të institucionit me qëllim reflektimin e praktikave më të mira bashkëkohore gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij.

Në përmbushje të detyrimit ligjor të ERRU-së për monitorimin e sektorit UK, ky raport jep edhe një pasqyrim të situatës aktuale të sektorit UK për vitin 2024, përfshirë dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e performancës së sektorit në të ardhmen.

Referuar Treguesve Kryesorë të Performancës të analizuar nga ERRU, gjendja e sektorit UK për vitin 2024 krahasuar me vitin e mëparshëm, paraqitet e përmirësuar pothuajse në të gjithë treguesit tekniko-financiarë, me përjashtim të treguesve të Normës së Arkëtimit Korrente dhe të Përgjithshme, të cilët kanë një rënie të lehtë. Gjithsesi, kjo nuk ka influencuar negativisht në performancën financiare të sektorit UK për vitin 2024, pasi mbulimi i kostove O&M në nivelin 109.8% paraqitet i përmirësuar me 9.3%. Të përmirësuar paraqiten edhe treguesit e tjerë të performancës, si: *Uji Pa të Ardhura, Niveli i Matjes, Eficienca e Stafit, Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, Mbulimi me Ujë dhe me Kanalizime, Eficienca e Energjisë dhe Ankesat e Klientëve*, të cilët kanë ndikuar në përmirësimin e situatës financiare të shoqërive UK dhe në cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve.

Konstatohet se, reforma në sektorin UK, në mbyllje të vitit të dytë të implementimit të saj ka dhënë impakt pozitiv në drejtim të përmirësimit në përgjithësi të situatës financiare të sektorit dhe rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar, krahasuar me vitin paraardhës 2023, të cilët kanë qenë dhe objektivat kryesorë të reformës.

ERRU, si institucion i pavarur për rregullimin e sektorit UK, në përmbushje të detyrimeve ligjore të tij do të vazhdojë angazhimin maksimal për të rritur dhe forcuar pavarësinë, transparencën, profesionalizmin, bashkëpunimin ndërinstitutional, brenda dhe jashtë vendit, në mënyrë të tillë që me autoritetin e vet rregullator të krijojë ekuilibrin e duhur midis ofruesve të shërbimit, politikëbërësve dhe konsumatorit.

Komisioni Kombëtar Rregullator

Përmbledhje

**Raporti Vjetor
2024 i
Aktivitetit të
ERRU-së
Instrument
Informimi dhe
Transparence**

Raporti Vjetor i ERRU-së paraqet veprimtarinë e këtij institucioni në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8102 dhe të Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së ERRU-së për vitin 2023”. Qëllimi i Raportit është informimi dhe transparencia ndaj Kuvendit të Shqipërisë, Kryeministrit, ndaj publikut dhe institucioneve që lidhen me sektorin e ujit, në përmbushje të misionit të tij që shoqëritë UK të ofrojnë për konsumatorët shërbime FU dhe KUN me cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm, si dhe të jenë financiarisht të qëndrueshme. Pjesë e këtij raporti është edhe analiza për gjendjen dhe performancën e sektorit të ujit, shoqëruar me rekomandimet përkatëse për rritjen e performancës. Gjithashtu, në raport përcaktohen edhe objektivat e punës së ERRU-së për vitin e ardhshëm në drejtim të forcimit të rolit të tij si institucion i pavarur.

**ERRU, Statusi
Ligjor,
Përgjegjësitë
dhe Struktura
Organizative**

ERRU, si institucion i pavarur, ushtron aktivitetin e tij bazuar në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar, i cili e ngarkon ERRU-në me këto përgjegjësi:

- Licencimin e shoqërive UK;
- Vendosjen e tarifave për shërbimet UK;
- Përcaktimin e standardeve dhe kushteve të shërbimit;
- Monitorimin e performancës së operatorëve UK;
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Struktura dhe organika e ERRU-së është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë sipas vendimit nr. 33 të vitit 2022 me 29 punonjës, nga të cilët 5 janë anëtarë KKRR, 1 Sekretar i Përgjithshëm, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës.

Në përgjigje të kërkesave të kohës për rregullimin e veprimtarisë së sektorit dhe për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së ERRU-së është i nevojshëm rishikimi në disa drejtime të ligjit aktual nr. 8102 për rregullatorin.

**Licencimi i
Shoqërive UK**

Në vijim të reformës në sektorin ujësjellës kanalizime, gjatë vitit 2024 kanë operuar 17 shoqëri UK, nga të cilat 14 shoqëri UK rajonale dhe 3 shoqëri UK ekzistuese, përkatësisht: UK Tiranë, Vorë, Kamzë.

Pranë ERRU-së kanë aplikuar për licencë të re apo rinovim 8 (tetë) shoqëri UK, nga të cilat 1 (një) për herë të parë, UK Rajonale Vlorë, 2 (dy) për efekt përfundim afati: UK Vorë dhe UK Rajonale Korçë, 4 (katër) për ndryshim drejtuesi ligjor UK Rajonale Shkodër, Kukës, Durrës dhe UK Tiranë, si dhe 1 (një) UK Rajonale Durrës për ndryshim drejtuesi teknik. Vlen të theksohet se, si rezultat i reformës janë kapërcyer vështirësitë e paraqitura më parë nga shoqëritë e vogla UK, të cilat në disa raste paraqisnin vështirësi për plotësimin e dokumentacionit përkatës për licencim, si akt miratimet higjieno - sanitare apo vendosja e drejtuesve teknikë të kualifikuar sipas përcaktimeve ligjore. Kështu, në mbyllje të vitit 2024 rezultojnë të pajisura me licencë të gjitha shoqëritë UK që operojnë në sektor (17 shoqëri UK).

**Procesi i
Miratimit të
Tarifave për
Shërbimet UK**

Gjatë vitit 2024, pranë ERRU kanë aplikuar për nivel të ri tarifar 6 shoqëri UK rajonale, përkatësisht: UKR Pogradec, Gjirokastër, Shkodër, Korçë, Elbasan dhe Berat. Në fund të vitit 2024 KKRR mori vendimet për tarifa për 3 shoqëri UK rajonale që kishin aplikuar që në vitin 2023 si: UKR Lezhë, Fier dhe Durrës si dhe për 3 shoqëri UK Rajonale që kanë aplikuar në vitin 2024 si: UKR Pogradec,

Gjirokastrë dhe Shkodër. Tre shoqëri të tjera, përkatësisht: *UKR Korçë, Elbasan dhe Berat* janë akoma në fazën e analizës tekniko – ekonomike.

UK Rajonale Pogradec ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifave fikse në zonën e shërbimit dhe ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura. Me tarifat e reja të miratuara synohet mbulimi deri në 109% i kostove O&M, si dhe janë vendosur objektiva sfiduese për treguesit kryesorë të performancës.

UK Rajonale Shkodër ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifave fikse në zonën e shërbimit, si dhe për ndryshimin e tarifave volumetrike për shërbimin e FU dhe KUN për të gjithë klientët. Me tarifat e reja të miratuara synohet mbulimi 92.3% i kostove operative, me fokus përmirësimin e treguesve financiarë të shoqërisë.

UK Rajonale Gjirokastrë ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifave fikse dhe rishikimin e tarifave volumetrike për shërbimin e FU dhe KUN për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit për një periudhë 3-vjeçare. Tarifat e reja të miratuara synojnë përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë me qëllim mbulimin 102% të kostove operative.

UK Rajonale Korçë ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifave fikse për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit si dhe unifikimin e tarifave volumetrike për dy zonat e shërbimit për një periudhë 5-vjeçare. Tarifat e reja të propozuara synojnë përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë me qëllim mbulimin e Kostove Totale mbi 100%.

UK Rajonale Elbasan ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifave volumetrike dhe fikse për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit për periudhën 3-vjeçare. Tarifat e reja të propozuara synojnë përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë me qëllim mbulimin kostove operative.

UK Rajonale Berat ka aplikuar me qëllim unifikimin e tarifës fikse në zonën e shërbimit, si dhe për ndryshimin e tarifave për shërbimin e FU dhe KUN për të gjithë klientët në zonën e shërbimit. Tarifat e reja të propozuara synojnë mbulimin e kostove operative mbi 100% me fokus përmirësimin e treguesve financiarë të shoqërisë .

Monitorimi i Performancës së Shoqërive UK

Monitorimi i performancës së shoqërive UK nga ERRU ka vijuar duke ndjekur një politikë komunikimi ndëraktive me shoqëritë, me qëllim mbështetjen e tyre gjatë procesit të riorganizimit. Në këtë kuadër, janë realizuar takime dhe vizita monitoruese në vend me shoqëritë UK Rajonale mbi problemet e licencimit, të tarifave sipas metodologjisë së re të tarifave, pagesat rregullatore si dhe diskutime mbi identifikimin e rrugëve për përmirësimin e performancës financiare etj.

Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK mbetet problematike për sektorin UK, e cila pritet të konsolidohet dhe të ketë ndikim pozitiv gjatë vitit 2025 me ngritjen e Sistemit të Integruar të të Dhënave dhe Treguesve Kryesorë të Performancës (IPIS), në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet ERRU dhe AKUK.

Mbrojtja dhe Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve

Mbrojtja e konsumatorit është një nga objektivat institucionale më të rëndësishëm të rregullatorit për të siguruar që shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura të jenë të qëndrueshme, të sigurta dhe të përballueshme për konsumatorët. Edhe në vitin 2024, në fokus të punës së ERRU-së, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit, ka qenë monitorimi i vazhdueshëm i Treguesve të Performancës, përmirësimi i Mekanizmave të Informimit si dhe trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve. VKM nr. 326, datë 29.05.2024, “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për

Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030”, në zbatim edhe të direktivave evropiane, ka vendosur në qendër konsumatorin dhe synon fuqizimin e tyre për një rol aktiv në treg. ERRU, si institucion kontribuues në këtë dokument strategjik ka përcaktuar rëndësinë e mbrojtjes së konsumatorit në drejtim të zbatimit të të drejtave të tyre, zgjidhjes alternative dhe online të mosmarrëveshjeve si dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve. Gjatë vitit 2024, në ERRU janë depozituar 25 ankesa me shkresë zyrtare të ardhura nga konsumatorë familjarë, privatë, publik si dhe ankesa të adresuara nga Avokati i Popullit. Përveç ankesave të paraqitura në mënyrë zyrtare, ERRU ka vijuar komunikimin dhe ka ofruar asistencë për 12 ankesa të tjera të ardhura direkt pranë zyrave të ERRU-së dhe kanaleve të komunikimit: e-mail; telefon; faqen zyrtare të ERRU-së në rubrikën “Dërgo një ankesë, si dhe me verifikime në terren dhe me zhvillimin e takimeve me shoqëritë UK. Natyra e ankesave për këtë vit lidhet me katër kategori: “Faturimi Aforfe”, “Cilësia e Shërbimit të Ofruar nga Shoqëritë UK”, “Zbatueshmëria e Kushteve të Kontratës për Shërbime Ujësjellës Kanalizime” si dhe “Të tjera”. Vlen të theksohet se 20 prej tyre kanë pasur një zgjidhje përfundimtare dhe të kënaqshme në favor të konsumatorit.

***Ecuria e
Reformës në
Sektorin UK
sipas VKM nr.
302, datë
11.05.2022***

Gjatë vitit 2024, procesi i rajonalizimit ka hyrë në një fazë të plotë operimi me formimin e 14 shoqërive UK rajonale të krijuara, nga totali prej 15 të tilla të parashikuara në reformë. Konkretisht, shoqëritë UK Rajonale: *Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Fier, Lushnje, Sarandë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Berat, Gjirokastrë dhe Vlorë*.

Procesi i riorganizimit ka vijuar të ndiqet me shumë intensitet nga ERRU duke licencuar në kohë shoqëritë UK rajonale të krijuara sipas reformës. ERRU ka licencuar 14 shoqëri UK rajonale nga 14 të krijuara, pasi mbetet akoma pa u krijuar shoqëria Rajonale UK *Tiranë* e cila përfshin bashkitë (Tiranë, Kamzë, Vorë) si rezultat i diskutimeve në vazhdim për pika të veçanta të karakterit teknik ndërmjet drejtuesve të pushteteve vendore dhe MIE.

Gjithashtu ERRU, ka luajtur një rol aktiv edhe gjatë procesit të aplikimit të shoqërive UK Rajonale për nivel të ri tarifor duke dhënë asistencën e nevojshme në këtë drejtim, pasi rajonalizimi i sektorit UK përkoi pothuajse në të njëjtën kohë edhe me metodologjinë e re të tarifave të miratuar nga ERRU sipas Vendimit të KKRR nr. 539, datë 30.12.2021. Në këtë kuadër, të gjitha shoqëritë UK rajonale të cilat kanë aplikuar për nivel të ri tarifor që nga momenti i fillimit të reformës (9 shoqëri UK Rajonale) janë asistuar nga ERRU në përmbushje të kërkesave të parashikuara në metodologjinë e tarifave. Gjatë aplikimeve për nivel të ri tarifor është vënë re tendenca për të unifikuar tarifat në të gjithë zonën e re të shërbimit. Referuar situatës aktuale të tarifave të këtyre shoqërive, para reformës rezulton se në disa raste është e pamundur të realizohet unifikimi i tarifave në këtë fazë fillestare për shkak të diferencave të mëdha ndërmjet zonës së shërbimit, por në disa nga shoqëritë rajonale, tarifat janë të përafërta nga zona në zonë duke krijuar kështu mundësitë për unifikim tarifor në të gjithë zonën e shërbimit. Gjithsesi, unifikimi tarifor duhet parë me kujdes rast pas rasti, pasi praktika ka treguar se nga rritja e menjëhershme dhe e konsiderueshme e tarifave, shoqëria mund të ndeshet me rezistencë nga ana e konsumatorëve duke mos paguar faturat e shërbimeve. Kjo do të ndikonte në uljen e normës së arkëtimit dhe aftësisë likuiduese të shoqërisë.

Agregimi i sektorit është një proces kompleks i cili kërkon vëmendje të vazhdueshme nga qeveria qendrore në drejtim të menaxhimit të asetëve ekzistuese dhe planifikimit sa më të drejtë të subvencioneve dhe investimeve të

nevojshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve si synimi final i këtij procesi.

Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

Burimet e financimit të aktivitetit të veprimtarisë së ERRU janë pagesat rregullatore vjetore të përcaktuara në kontratat me Shoqëritë UK si dhe pagesat për licencime.

Të ardhurat totale nga veprimtaria gjatë vitit 2024 janë 81 850 340 lekë, përbërë nga:

- Pagesat rregullatore vjetore 2024, referuar kontratave në fuqi me shoqëritë rajonale SKP dhe me shoqëritë UK dhe në vlerë 81.160.340 lekë;
- Licencimet e reja dhe rinovimet e licencave të shoqërive UK gjatë e vitit në vlerë 690.000 lekë.

Shpenzimet buxhetore të kryera nga ERRU gjatë vitit 2024 janë realizuar në shumën 60 577 152 lekë, nga 71 217 100 lekë të planifikuara për tu shpenzuar gjatë vitit.

Në mbyllje të vitit 2024, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të ERRU-së garanton plotësisht realizimin e parashikimit të planit të shpenzimeve të vitit 2025.

Performanca e Sektorit UK dhe Analiza e çdo Treguesi të Veçantë

Monitorimi i performancës së sektorit UK është në fokus të vazhdueshëm të ERRU, i cili realizohet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës, të miratuar nga KKRR. Për vitin 2024 kanë raportuar të dhënat 14 shoqëri UK Rajonale nga 15 që parashikon reforma sipas VKM Nr.302 dhe 3 shoqëri UK ekzistuese para reformës. Situata e sektorit UK sipas Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023 jepet në Tabelën nr.1.

Tabela nr. 1. Treguesit Kryesorë të Performancës për vitet 2023-2024

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2023	Viti 2024	Tendenca
1	Uji Pa të Ardhura	%	64.7	61.1	↗
2	Mbulimi i Kostove O&M	%	100.5	109.8	↗
3	Norma e Arkëtimit Korrente	%	83.9	83.2	↘
4	Norma e Arkëtimit të Përgjithshme	%	103.5	102.4	↘
5	Niveli i Matjes	%	86.5	87.9	↗
6	Efienca e Stafit	staf/1000 lidhje UK	4.56	4.51	↗
7	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	16.3	17.3	↗
8	Mbulimi i Furnizimit me Ujë	%	75.3	77.2	↗
9	Mbulimi me Kanalizime	%	54.8	56.2	↗
10	Efienca e Energjisë FU	kWh/m³	0.63	0.58	↗-
11	Ankesat e Klientëve	%	4.23	3.6	↗

Burimi: ERRU

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se reforma në sektorin UK, në mbyllje të vitit të dytë të implementimit të saj, ka dhënë impakt pozitiv në drejtim të përmirësimit në përgjithësi të situatës financiare të sektorit dhe rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar krahasuar me vitin paraardhës 2023, të cilët kanë qenë dhe objektivat kryesorë të reformës.

Pothuajse të gjithë treguesit kryesorë tekniko - financiare të performancës paraqiten të përmirësuar, me përjashtim të treguesve të Normës së Arkëtimit Korrente dhe të Përgjithshme, të cilët kanë një rënie të lehtë. Gjithsesi vlera e këtyre treguesve duhet marrë me rezervë në këtë moment, pasi raportimet nga ana e shoqërive UK janë paraprake para mbylljes së balanceve financiare të

certifikuara. Vlen të theksohet se kjo nuk ka influencuar negativisht në performancën financiare të sektorit UK për vitin 2024, pasi mbulimi i kostove O&M në nivelin 109.8%, paraqitet i përmirësuar me 9.3%. Të përmirësuar paraqiten edhe treguesit e tjerë të performancës, si: Uji Pa të Ardhura, Niveli i Matjes, Eficenca e Stafit, Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, Mbulimi me Ujë dhe me Kanalizime, Eficenca e Energjisë dhe Ankesat e Klientëve, të cilët kanë ndikuar në përmirësimin e situatës financiare të shoqërive UK dhe në cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve.

Në detaje, Treguesit Kryesorë të Performancës analizohen si më poshtë:

"Uji Pa të Ardhura" për vitin 2024 është përmirësuar ndjeshëm me rreth 3.6% krahasuar me një vit më parë, përkatësisht nga 64,7% në 61.1%. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rritjes së volumit të ujit të faturuar me rreth 5.7 milionë m³ dhe uljes së atij të prodhuar me 16.5 milionë³, nga të cilat rreth 13 milionë m³ me ngritje mekanike. Pothuajse të gjitha shoqëritë kanë performuar mirë në këtë drejtim, ku përmenden shoqëritë UK Kamzë, UKR Lezhë, UKR Durrës, UKR Elbasan dhe UKR Sarandë.

"Mbulimi i Kostove O&M" është në nivelin e 109.8% nga 100.5% në vitin 2023. Janë 8 shoqëri UK, nga të cilat 7 rajonale dhe 1 ekzistuese që mbulojnë mbi 100% kostot O&M, si UKR Korçë, Berat, Gjirokastrë, Lezhë, Pogradec, Sarandë, Kukës dhe UK Tiranë, ndërsa pjesa tjetër e shoqërive (9 shoqëri) i mbulojnë ato nga 75% deri 100%, ku 2 shoqëri: UK Vorë dhe UK Kamzë janë shoqëri ekzistuese. Mbulimi i Kostove Totale për vitin 2024 arrihet vetëm nga shoqëria UK Tiranë.

"Norma e Arkëtimit", Korrente dhe e Përgjithshme, për vitin 2024 ka një rënie të lehtë. Përkatësisht ajo Korrente në 83.2% nga 83.9% dhe ajo e Përgjithshme në 102.4 nga 103.5%. Ndikimin kryesor në përkeqësimin e këtyre treguesve e jep *shoqëria UK Tiranë* me rënie të normës së arkëtimit korrente në (-4.4%), e cila përbën dhe pjesën kryesore në përkeqësimin e këtij treguesi pasi mbetet shoqëria UK më e madhe në sektor me rreth 36% të totalit të të ardhurave të sektorit.

"Niveli i Matjes" prej 87.9% është përmirësuar me 1.4% krahasuar me 2023. Në 2024 janë instaluar rreth 33,236 matës uji, por ende raportohen 119,026 klientë pa matës, nga të cilët 4514 janë të kategorisë jo familjarë nga 5250 që ishin në 2023.

"Eficenca e Stafit" me 4,51 staf/1000 lidhje UK nga 4.56 ka një përmirësim të lehtë me 0.05%, kjo si rezultat i shtimit të lidhjeve me ujë me rreth 29,233 lidhje, pasi numri i stafit është shtuar me 34 punonjës.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" në rang sektori raportohet 17.3 orë/ditë me një përmirësim prej 1 orë/ditë. Janë 8 shoqëri UK Rajonale që ofrojnë shërbimin e Furnizimit me Ujë 20-24 orë/ditë si: UKR Korçë, Lezhë, Berat, Gjirokastrë, Pogradec, Shkodër, Sarandë dhe Dibër, ndërsa 4 shoqëri UK Rajonale dhe shoqëria UK Tiranë me 13-20 orë në ditë. Pjesa tjetër e shoqërive 4 prej tyre ofrojnë furnizimin me ujë 4-13 orë/ditë. Më keq performojnë shoqëritë UK Kamzë me 4 orë/ditë dhe UK Vorë me 8 orë/ditë.

Furnizimi me ujë të pandërprerë në 24/7, sipas raportimeve, ofrohet vetëm nga Shoqëria Rajonale UK Lezhë.

"Mbulimi i Furnizimit me Ujë" është në nivelin e 77.2% dhe është përmirësuar me 1.9% krahasuar me vitin 2023. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rritjes së popullsisë së shërbyer me 121,222 banorë. Ndikimi kryesor ka ardhur nga shoqëritë: UK Tiranë, UK Rajonale Durrës, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër, Berat dhe Lezhë.

"Mbulimi me Kanalizime" është përmirësuar me 1.4% dhe paraqitet në nivelin 56.2%. Përmirësimi i këtij treguesi vjen si rezultat i rritjes së popullsisë me shërbimin e KUN me rreth 97,000 banorë. Në sektor janë akoma rreth 87 mijë klientë, të cilët e realizojnë grumbullimin e ujërave të ndotura nëpërmjet gropave septike, gjë që tregon nevojën e rritjes së vëmendjes për investime në drejtim të kanalizimeve.

"Eficenca e Energjisë" është 0.58 kWh/m³ nga 0.63 kWh/m³ që ishte në vitin 2023. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur nga ulja e konsumit të kWh me rreth 5 milionë kWh, si rezultat i investimeve të reja në pompa si dhe i rënies së volumit të ujit të prodhuar me ngritje mekanike dhe në disa raste, si rezultat i rakordimeve të bëra nga shoqëritë UK me OSHE për faturime të pasakta.

"Ankesat e Klientëve" janë 3.6% nga 4.23 që ishin në vitin 2023, me një ulje prej 5,000 ankesash për të gjithë sektorin. Përmirësimi i këtij treguesi lidhet edhe me konsolidimin e shoqërive UK rajonale gjatë vitit të dytë të operimit të tyre. Ndikimin kryesor në përmirësimin e këtij treguesi e kanë dhënë kryesisht shoqëritë: **UK Rajonale Shkodër, Gjirokastrë, Fier, Berat dhe Pogradec.**

**Objektivat e
ERRU-së për
Vitin 2025**

- Të përfundojë procesin e miratimit të tarifave për të gjitha shoqëritë rajonale UK të krijuara, në kuadër të riorganizimit të sektorit si dhe të ofrojë asistencën rregullatore në zbatimin efektiv të metodologjisë për vendosjen e tarifave nga ana e shoqërive UK.
- Të përfundojë procesin e krijimit të një sistemi të unifikuar kombëtar raportimi të dhënash në kohë reale dhe të detajuar lidhur me shërbimet UK, me synim rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave dhe vlerësimit sa më real të gjendjes së sektorit UK.
- Të miratojë Modelin e Plan Biznesit për shoqëritë UK dhe udhëzuesin përkatës, i detyrueshëm për t'u respektuar nga të gjithë shoqëritë në momentin e aplikimit për nivel të ri tarifor pranë ERRU-së, në vijim të marrëveshjes së nënshkruar me AKUK.
- Të intensifikojë punën nëpërmjet kanaleve të komunikimit për ndërgjegjësimin e konsumatorit për rolin ndërveprues që ka në marrëdhënie me ofruesit e shërbimit dhe sensibilizimin për mundësinë e pjesëmarrjes në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet dedikuar shërbimeve UK.
- Të luajë një rol kryesor dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët që operojnë në sektorin e ujit për të bërë të mundur realizimin e objektivave strategjike sektoriale, si dhe për krijimin e një mjedisi që siguron stabilitet për shoqëritë UK dhe shërbimin më të mirë për konsumatorët.
- Të vijojë trajtimin e ankesave të konsumatorëve nëpërmjet mjeteve të ankimimit dhe strukturës së ngritur posaçërisht për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve.
- Të vijojë bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare dhe rregullatorët evropiane për të ndarë njohuritë dhe përvojat si dhe të mbajë një qasje ndërvepruese në identifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e praktikave më të mira rregullatore.
- Të kontribuojë në mënyrë aktive mbi aspektet rregullatore në të gjitha grupet e punës ndërinstitutionale që lidhen me politika strategjike apo tematika specifike të sektorit UK apo ato të mbrojtjes së konsumatorit.

- Të rrisë kapacitetet profesionale të stafit, me një planifikim të drejtë të trajnimit të tyre me burime të brendshme dhe të jashtme duke shfrytëzuar edhe mundësitë nga bashkëpunimet e gjera dhe bilaterale me rregullatorët evropianë të sektorit të ujit.
- Në përgjigje të statusit të hapjes së negociatave me BE, të kontribuojë në përmbushje të kërkesave të “Acquis Communautaire” të Shqipërisë në lidhje me direktivat evropiane për ujin e pijshëm, ujërat e ndotura dhe të llumrave të ITUN.

***Rekomandime
për
Përmirësimin e
Performancës
së Sektorit UK
dhe të ERRU-së***

- Të planifikohen investime të dedikuara dhe të alokohen fondet përkatëse nga AKUK për pajisjen e të gjithë sistemeve të FU, me ujëmatës të mëdhenj në burim dhe te konsumatorët, në mënyrë që shoqëritë UK të kenë mundësinë e vlerësimit dhe reduktimit të humbjeve, evidentimit të gjendjes reale të kërkesës për ujë dhe mbrojtjen e burimeve.
- Të hartohen nga shoqëritë rajonale UK Planet e Menaxhimit të Aseteve për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e asetëve që mund të përmirësojë efikasitetin në mënyrën se si administrohen asetet si dhe uljen e kostove të mirëmbajtjes.
- Në përgjigje të ndryshimeve të shpejta të kushteve klimatike dhe zhvillimit të teknologjisë e industrisë në fushën e ujit, në bashkëpunim me AKUK, të hartohen planet afatshkurtra dhe afatgjatë të investimeve në infrastrukturën aktuale të sistemeve FU dhe KUN.
- Të vijojë procesi i rishikimit dhe miratimit të kuadrit të ri ligjor rregullator në sektorin e ujit sipas zhvillimeve që ka pësuar sektori dhe rregullimi sipas standardeve dhe direktivave evropiane për ujin e pijshëm dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura.
- Duke patur parasysh që një pjesë e mirë e kostove të justifikuar që duhet të mbulohen me tarifa e përbëjnë investimet e reja, duhet të krijohet mundësia që ERRU të përfaqësohet për të dhënë rekomandimet e saj në komisionet teknike pranë AKUK për aprovimin e projekteve të reja për investime.

1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit

1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) është një institucion thelbësor për funksionimin dhe përmirësimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri. ERRU funksionon në përputhje me ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, i ndryshuar. Ky ligj përcakton kornizën ligjore për rregullimin e këtij sektori, duke garantuar funksionimin e drejtë dhe të qëndrueshëm të operatorëve që ofrojnë këto shërbime pa anashkaluar dhe përmbushjen e nevojave të konsumatorëve. Si një organ i pavarur, ERRU luan një rol rregullator dhe mbikëqyrës, duke siguruar që të gjitha palët e përfshira në këtë sektor të përmbushin detyrimet e tyre dhe të operojnë sipas rregullave të caktuara.

Për 27 vite, ERRU ka kryer një rol thelbësor në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e këtij sektori, ku në fushën e veprimtarisë së vet kryen licencimin e subjekteve që operojnë në sektorin e ujit dhe kanalizimeve, duke përcaktuar kushte të qarta për funksionimin e tyre; vendos në përputhje me metodologjinë respektive tarifat për shërbimet ujësjellës kanalizime duke u siguruar që ato të jenë të përballueshme për konsumatorët dhe që të gjitha veprimtaritë të kryhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet teknike.

Gjithashtu, ERRU monitoron performancën e operatorëve duke analizuar cilësinë e furnizimit me ujë, mirëmbajtjen e rrjetit dhe shërbimin ndaj konsumatorit dhe kontribuon në krijimin e standardeve dhe rregullave uniforme për të gjithë sektorin. Një tjetër përgjegjësi e ERRU-së është marrja e masave administrative ndaj shoqërive që veprojnë në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 8102.

Gjatë vitit 2024, ERRU ka arritur rezultate të konsiderueshme në drejtim të përmirësimit të performancës së sektorit të furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Në përputhje me “Strategjinë Kombëtare të Sektorit për Furnizimin me Ujë të Pijshëm, Largimin, Grumbullimin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane 2023–2030” miratuar me VKM nr. 448, datë 26.07.2023, ERRU ka kontribuar në mënyrë aktive në disa drejtime kryesore në përmbushje të objektivave të përcaktuar, si përmirësimi i ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë, përmes një monitorimi më të rreptë të cilësisë së shërbimit dhe sigurisë së burimeve ujore.

1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë

Viti 2024 shënoi një hap tjetër suksesi drejt rrugës së vendit tonë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian me zhvillimin e dy konferencave ndërqeveritare për kapitujt kryesorë si proces i negociatave për përthithjen e “acquis” të BE-së në sistemin kombëtar juridik.

Si pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për Nën kapitullin 28 “Mbrotjtja e Konsumatorit”, gjatë këtij viti ERRU ka vijuar angazhimin për të dhënë kontributin e tij në procesin për hartimin e Programit Kombëtar për aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2024-2030

dhe të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2024 – 2026 (PKIE) 2024-2026 për kapitullin 28 “Mbrotjtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik”.

Gjithashtu, fokusi i punës për këtë vit ka qenë edhe kontributi në hartimin e Raportit Kombëtar të Veprimtarisë GNPIE & Vlerësimit të Indeksit të Kapaciteteve të Integritimit Evropian semestrale dhe vjetore, si dhe hartimi i Planit Menaxherial për Integritimin Evropian (PSIE) për Forcimin e Kapaciteteve Administrative dhe Institucionale, si një instrument planifikimi për koordinimin dhe forcimin e kapaciteteve të strukturave negociuese me qëllim përmirësimin e proceseve të punës në kuadër të negociatave dhe integritimit evropian.

1.3 Struktura Organizative e ERRU-së

Forma organizative, struktura dhe organika e ERRU-së rregullohen në përputhje me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për Pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të Pavarura Kushtetuese dhe të Institucioneve të tjera të Pavarura, të krijuara me ligj”. Si institucion i pavarur, i krijuar me ligj, struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të nëpunësve të Entit Rregullator të Ujit, miratohen me vendim të Kuvendit. Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 33/2022, “Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)”. Me miratimin e kësaj strukture, për Entin u mundësua realizimi i përmirësimeve dhe ndryshimeve të nevojshme në kuadër të ristrukturimit të sektorit UK. Ndryshimi erdhi edhe si përpjekje e ERRU-së për përmirësimin e kapaciteteve të tij. Gjatë vitit 2022, në përputhje me strukturën organizative, kapacitetet njerëzore të ERRU janë rritur duke plotësuar strukturën me pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm. Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë gjithsej 29 punonjës, nga të cilët 5 Anëtarë Komisioni, 1 Sekretar i Përgjithshëm, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës.




Figura nr.1. Struktura e Entit Rregullator të Ujit

Kjo strukturë ka për qëllim rritjen e efikasitetit, profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të rregullatorit duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat dhe sfidat që ERRU ka përballë reformës së sektorit UK që burojnë edhe nga objektivat strategjike të institucionit.

1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese

1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK

Në sektorin UK shërbimi i *"grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik"* kryhet nga 14 (katërmëdhjetë) shoqëri rajonale (subjekte me kompetenca të përbashkëta) të licencuara nga ERRU dhe 3 (tre) shoqëri UK ekzistuese si UK: Tiranë, Vorë, Kamzë, të cilat ende nuk janë rajonalizuar sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022.

Shërbimin e *"përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik"* e kryejnë 2 (dy) shoqëri UK Tiranë me impiantin e trajtimit të ujit të pijshëm të Bovillës dhe Shoqëria Rajonale UK Durrës, me impiantin e Ujit të pijshëm të Maskurisë (Kavajë). Shërbimi i *"grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura"* ofrohet nga të gjitha shoqëritë, ndërsa përpunimi i tyre arrihet të kryhet vetëm nëpërmjet 6 (gjashtë) impianteve të ndërtuara pjesë e shoqërive Rajonale Durrës (ITUN Durrës, Kavajë), Shkodër (ITUN Velipojë dhe Shirokë), Lezhë, Korçë, të cilat janë të pajisur me licencë nga ERRU. Mbeten 3 (tre) prej

tyre që ende nuk plotësojnë kërkesat ligjore për licencim për këtë kategori shërbimi Shoqëria Rajonale UK Sarandë (ITUN Sarandë) dhe UK Vlorë (me ITUN Vlorë dhe Orikum).

Gjatë vitit 2024, pas përfundimit të procedurave të riorganizimit, aplikuan për licencim për herë të parë dhe u licencua 1 (një) shoqëri e re rajonale **Shoqëria Rajonale UK Vlorë**. Numri i shoqërive që kanë përfunduar procesin e riorganizimit dhe që janë licencuar deri në fund të vitit 2024 e çojnë në 14 (katërmëdhjetë) numrin e shoqërive rajonale që deri më tani kanë përfunduar riorganizimin dhe janë licencuar nga ERRU.

Në zbatim të VKM nr. 302, datë 11.05.2022, mbetet vetëm 1 (një) shoqëri rajonale e pa riorganizuar, **Shoqëria Rajonale UK Tiranë**, (e cila akoma nuk ka iniciuar asnjë hap për rajonalizimin) ku do të përfshihen shoqëritë ekzistuese UK Tiranë, UK Kamzë dhe UK Vorë. Vlen të theksohet që VKM nr. 302 nuk është detyruese për riorganizimin në subjekte me kompetenca të përbashkëta. Ky riorganizim nisi me marrëveshjet e pushtetit vendor, si pronarët e shoqërive UK dhe Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës.

Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, gjatë vitit 2024, pranë Enti Rregullator të Ujit, kanë paraqitur dokumentacionin të aplikimit për licencë apo rinovim licence, 8 (tetë) shoqëri.

Këto aplikime kanë qenë për efekt të:

- Licencim për herë të parë si SKP **1 (një)** shoqëri e re rajonale UK Vlorë.
- Përfundim afati, **2 (dy)** shoqëri (UK Rajonale Korçë dhe ekzistuese UK Vorë).
- Ndryshim drejtuesi ligjor **3 (tre)** shoqëri, nga të cilat 2 (dy) shoqëri rajonale (Kukës, Shkodër) dhe 1 (një) shoqëri ekzistuese, UK Tiranë.
- Ndryshim drejtuesi ligjor dhe teknik **1 (një)** shoqëri rajonale, UK Durrës.
- Ndryshim drejtuesi teknik **1 (një)** shoqëri rajonale, UK Durrës.

Enti Rregullator i Ujit ka marrë në shqyrtim të gjitha aplikimet e mësipërme për licencim apo rinovim licence, të cilat më pas kanë kaluar për vendimmarrje dhe janë miratuar në KKRR.

Në përfundim, gjatë vitit 2024, KKRR ka miratuar licencimin apo rinovim licence për **8 (tetë)** shoqëri, ku shoqëria Rajonale UK Durrës, ka aplikuar dy herë brenda vitit për ndryshim drejtuesi ligjor dhe teknik. (shih aneksi 1 tabela 1).

Vlen të theksohet se në mbyllje të vitit 2024, të gjitha shoqëritë UK që operojnë në sektor (17 shoqëri) janë të pajisura me licencë nga ERRU. Kjo si rezultat i reformës, e cila duket se ka ndikuar pozitivisht në drejtim të zgjidhjes së problematikave që kishin shoqëritë UK, kryesisht ato të vogla për plotësimin e kushteve të licencimit si marrja e akt miratimeve higjieno sanitare apo gjetja e drejtuesve teknikë të kualifikuar.

Situata e licencimit deri në fund të vitit 2024 për shoqëritë UK ekzistuese dhe të ndara sipas shoqërive të reja rajonale paraqitet si më poshtë në tabelën nr.2.

Tabela nr. 2. Situata e licencimit për vitin 2024

Nr.	Ndarja e Shoqërive Rajonale	Shoqëritë UK Ekzistuese	Statuti i shoqërisë	Mbarimi i afatit të licencimit	Licencimi i Shoqërive UK ekzistuese/rajonale
1	Sh.R UK Shkodër	Shkodër	Riorganizuar	26.12.2027	Me licencë
		Fushë Arrëz			
		Pukë			
		Vau i Dejës			
2	Sh.R UK Kukës	Malësia e Madhe	Riorganizuar	29.01.2027	Me licencë
		Kukës			
		Tropojë			
		Has			
3	Sh.R UK Lezhë	Lezhë	Riorganizuar	01.12.2026	Me licencë
		Mirditë			
		Kurbin			
		Dibër			
4	Sh.R UK Durrës	Mat	Riorganizuar	22.06.2027	Me licencë
		Bulqizë			
		Klos			
		Durrës			
5	Sh.R UK Fier	Krujë	Riorganizuar	21.02.2027	Me licencë
		Kavajë			
		Rrogozhinë			
		Fier			
6	Sh.R UK Lushnje	Patos	Riorganizuar	02.03.2025	Me licencë
		Roskovec			
		Mallakastër			
		Lushnje			
7	Sh.R UK Elbasan	Divjakë	Riorganizuar	02.03.2027	Me licencë
		Elbasan			
		Cërrik			
		Belsh			
8	Sh.R UK Sarandë	Librazhd	Riorganizuar	27.04.2027	Me licencë
		Gramsh			
		Peqin			
		Sarandë			
9	Sh.R UK Berat	Finiq	Riorganizuar	27.04.2027	Me licencë
		Konispol			
		Delvinë			
		Berat - Kuçovë			
10	Sh.R UK Korçë	Ura Vajgurore	Riorganizuar	02.03.2027	Me licencë
		Poliçan			
		Skrapar			
		Korçë			
11	Sh.R UK Pogradec	Devoll	Riorganizuar	01.12.2024	Me licencë
		Maliq			
		Kolonjë			
		Pustec			
12	Sh.R UK Gjirokastrë	Pogradec	Riorganizuar	27.04.2027	Me licencë
		Përrenjas			
		Gjirokastrë			
		Tepelenë			
13	Sh.R UK Vlorë	Këlcyrë	Riorganizuar	21.02.2027	Me licencë
		Përmet			
		Libohovë			
		Dropull			
14	Sh.R UK Tiranë	Memaliaj	Riorganizuar	07.11.2028	Me licencë
		Vlorë			
		Selenicë			
		Himarë			
15	Sh.R UK Tiranë	Tiranë	Pa riorganizuar	21.02.2027	Me licencë
		Kamzë		27.02.2026	Me licencë
		Vorë		19.12.2028	Me licencë

1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor

Metodologjia dhe procedura për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime, sipas vendimit të KKRR nr. 539 datë 30.12.2021 “Për Miratimin e Metodologjisë dhe Procedurës për Miratimin e Tarifave të Shërbimeve UK” i ndryshuar, është një dokument në koherencë të plotë me kërkesat dhe në përgjigje të situatës aktuale të sektorit UK pas reformës dhe ri organizmit të shoqërive në 15 shoqëri UK Rajonale.

Metodologjia e tarifave përcakton rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur për llogaritjen e tarifave të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, të cilat miratohen nga ERRU, në mënyrë që të arrihet një performancë e qëndrueshme teknike e financiare me fokus mbrojtjen e klientëve nga çmimet monopol. Tarifat janë elementët bazë që kushtëzojnë qëndrueshmërinë financiare të shoqërive rajonale UK, me anë të të cilave realizohen nevojat për të ardhura për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, përfshirë dhe trajtimin e tyre, grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotura.

Viti 2024 konsiderohet si viti i dytë i implementimit të reformës në sektorin UK, sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022, ku deri më tani janë krijuar 14 shoqëri UK Rajonale nga 15 që parashikon reforma. Si rezultat i reformës dhe sfidave të paraqitura gjatë implementimit të saj në terren, shoqëritë e reja UK rajonale të krijuara nuk arritën që të aplikonin në kohë sipas përcaktimeve të metodologjisë së tarifave ku afati përfundimtar për aplikim është data 30 qershor i çdo viti. Në këtë situatë, ERRU edhe për vitin 2024, duke marrë në konsideratë problematikat e shoqërive UK rajonale të krijuara kryesisht nga mungesa e opinioneve të këshillave bashkiake, vendosi për shtyrjen e afatit të aplikimeve për nivel të ri tarifor, për shoqëritë UK rajonale: Shkodër, Berat, Elbasan dhe Korçë, duke u lënë afat për plotësimin e dokumentacionit deri më 9 gusht.

Në përfundim të afatit të përcaktuar nga KKRR për aplikimet e shoqërive UK për nivel të ri tarifor, për vitin 2024, pranë ERRU aplikuan 6 shoqëri të riorganizuara si shoqëri UK rajonale, përkatësisht: **UK Rajonale Pogradec, Gjirokastrë, Shkodër, Korçë, Elbasan, dhe Berat.**

Pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të aplikimeve për 6 shoqëritë UK rajonale, KKRR mori vendimin për fillimin e procedurës së analizës për aplikimet për nivel të ri tarifor për shoqëritë Rajonale **UK Rajonale Pogradec, Gjirokastrë, Shkodër, Korçë, Elbasan, dhe Berat.**

Gjatë vitit 2024, ERRU ka përfunduar analizat tekniko-ekonomike dhe ka marrë vendimet përfundimtare nga KKRR për tarifa për 6 shoqëri UK rajonale përkatësisht shoqëritë: UKR Lezhë, Fier, Durrës, të cilat kanë qenë aplikime të vitit 2023 dhe shoqëritë UKR Pogradec, Gjirokastrë dhe Shkodër, të cilat kanë aplikuar në vitin 2024. Ndërkohë, janë akoma në proces të analizës tekniko - ekonomike tre shoqëritë UK Rajonale Korçë, Elbasan dhe Berat.

Tabela nr.3 . Shoqëritë për të cilat KKRR ka marrë vendim dhe shoqëritë në proces analize.

Nr.	Shoqëria	Numri i Vendimit të KKRR	Data e Vendimit
1	UK Rajonale Pogradec	21	09.07.2024
2	UK Rajonale Shkodër	46	02.12.2024
3	UK Rajonale Gjirokastrë	47	02.12.2024
4	UK Rajonale Korçë		Proces analize
5	UK Rajonale Berat		Proces analize
6	UK Rajonale Elbasan		Proces analize

Metodologjia e Tarifave konsiston në dy metoda të përcaktimit të tarifave, metoda “Kosto Plus” për shoqëritë që mbulojnë deri në 100% kostot operacionale dhe metoda “Çmimi Tavan” për shoqëritë që mbulojnë mbi 100% kostot operacionale. Shoqëritë e mësipërme, të cilat kanë aplikuar për nivel të ri tarifor gjatë vitit 2024, pesë prej tyre (SHRUK Pogradec, SHRUK Shkodër, SHRUK Gjirokastrë, SHRUK Berat, SHRUK Elbasan) bëjnë pjesë në grupin e shoqërive që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M mbi 100%. Si rrjedhojë, këto shoqëri kanë aplikuar referuar metodës “Kosto Plus”, ndërsa Shoqëria Rajonale UK Korçë bën pjesë në grupin e shoqërive që arrijnë të mbulojnë kostot O&M mbi 100%, e cila duhet theksuar që është shoqëria e parë në sektor që ka aplikuar sipas metodës së re “Çmimi Tavan”. Zbatimi i kësaj metode mundëson planifikimin që me anë të tarifave të mbulohen pjesërisht ose tërësisht nevojat për investime fizike në të ardhmen, por pa cenuar kriterin e përballueshmërisë nga klientët në pagesën e faturës së shërbimeve UK.

Arsyet kryesore të aplikimeve për tarifa të reja nga shoqëritë e mësipërme kanë qenë:

- Përmbushja e detyrimit ligjor nga shoqëritë UK të aplikimit për tarifa të reja sipas vendimit nr. 302 datë 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të FU dhe KUN” me tendencë unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit.
- Përmbushja e detyrimit ligjor për shoqëritë UK për të aplikuar tarifa të miratuara nga ERRU, në përputhje me nenin 14 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të FU dhe KUN", i ndryshuar, si autoritet i vetëm që miraton tarifat e shërbimeve UK.
- Aplikimi për tarifa të reja për të rritur qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, në përputhje me nenin 22, Ligji nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të FU dhe KUN " i ndryshuar, për mbulimin 100% të kostove operacionale me qëllim përmirësimin e shërbimit të ofruar, mirëmbajtjen e rrjetit, stacioneve të pompimit, makinerive etj.
- Aplikim për tarifa të reja për shkak të rritjes së çmimeve/njësi, sidomos të energjisë elektrike dhe materialeve për shoqëritë që prodhojnë ujë me ngritje mekanike si edhe të pagës minimale në shkallë vendi.

Më poshtë jepen detaje të aplikimeve të mësipërme për secilën shoqëri UK:

UK Rajonale Pogradec ka aplikuar në prill të vitit 2024, pas licencimit si SKP në zbatim të VKM nr.302, me qëllim unifikimin e tarifave fikse në zonën e shërbimit si dhe ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura. Me tarifat e reja të miratuara synohet mbulimi deri në 109% i kostove të O&M si dhe janë vendosur objektiva sfidues për treguesit kryesorë të performancës.

UK Rajonale Shkodër ka aplikuar për herë të parë në qershor 2024, pas licencimit si SKP në zbatim të VKM nr.302, me qëllim unifikim e tarifave fikse në zonën e shërbimit, si dhe për ndryshimin e tarifave volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura për të gjithë klientët. Tarifat e reja të propozuara synojnë mbulimin 92.3% të kostove operative me fokus përmirësimin e treguesve financiarë të shoqërisë .

UK Rajonale Gjirokastrë ka aplikuar për herë të parë në qershor 2024, pas licencimit si SKP në zbatim të VKM nr.302, me qëllim unifikimin e tarifave volumetrike dhe fikse për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit për periudhën 3-vjeçare. Tarifat e reja të propozuara synojnë përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë me qëllim mbulimin 102% të kostove operative.

UK Rajonale Korçë ka aplikuar për herë të parë në qershor 2024, pas licencimit si SKP në zbatim të VKM nr.302, me qëllim unifikimin e tarifave fikse për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit ai dhe unifikimin e tarifave volumetrike për dy zonat e shërbimit për periudhën 5-vjeçare. Tarifat e reja të propozuara synojnë përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë, me qëllim gjenerimin e më shumë të ardhurave për përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë me qëllim mbulimin e kostove Totale mbi 100%.

UK Rajonale Elbasan ka aplikuar për herë të parë në qershor 2024 pas licencimit si SKP, në zbatim të VKM nr.302, me qëllim unifikimin e tarifave volumetrike dhe fikse për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit për periudhën 3-vjeçare. Tarifat e reja të propozuara synojnë përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë me qëllim mbulimin kostove operative.

UK Rajonale Berat ka aplikuar për herë të parë në qershor 2024 pas licencimit si SKP, në zbatim të VKM nr.302, me qëllim unifikim e tarifave fikse dhe volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura për të gjithë klientët në zonën e shërbimit. Tarifat e reja të propozuara synojnë mbulimin e kostove operative mbi 100% me fokus përmirësimin e treguesve financiarë të shoqërisë .

Gjatë analizës së propozimeve për tarifa të reja, konstatohen probleme lidhur me raportimin e të dhënave kryesisht për numrin e lidhjeve të reja që nuk përputhet me planifikimin e vëllimeve të parashikuara për faturim, të bilancit të ujit, si edhe konsumi i parashikuar i energjisë elektrike dhe kosto e parashikuar për paga e sigurime etj, të cilat nuk kanë rezultuar të llogaritura saktë. Në zbatim të metodologjisë së re të aplikimit, shoqëritë rajonale duhet të krijojnë dhe mirëmbajnë sistemet e informacionit për të dhënat, pasi ERRU do të vlerësojë cilësinë e të dhënave të raportuara, të cilat do të ndikojnë në vendimin përfundimtar të tarifave të aprovuara prej saj si bonus apo penalitet.

ERRU, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit nga tarifat e larta të pajustificuara, në analizën dhe vendimmarrjen për tarifa të reja vlerëson kriterin e përballueshmërisë së faturës së llogaritur për shërbimet e ofruara për konsumatorët familjarë. Fatura e llogaritur me tarifat e miratuara nga ERRU nuk e kalon nivelin prej 5% të shpenzimeve mujore të Njësisë Ekonomike Familjare (NJEF), që INSTAT publikon çdo vit në dokumentin "Anketa e Buxhetit të Familjes për vitin 2023", e publikuar në vitin 2024 për të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, ERRU i kushton një rëndësi të veçantë zhvillimit të seancave dëgjimore me publikun, si kusht i domosdoshëm për t'u realizuar nga shoqëritë UK, të cilat shërbejnë si instrument transparence

ndaj konsumatorëve për të justifikuar përpara tyre tarifat e reja që shoqëria synon të aplikojë. Gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore konsumatorët kanë mundësinë të shprehin kërkesat e tyre në drejtim të masave të nevojshme që duhen ndërmarrë nga shoqëritë UK për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar. ERRU ndjek nga afër dhe merr pjesë në zhvillimin e seancave dëgjimore të organizuara nga shoqëritë UK me qëllim monitorimin dhe organizimin e tyre sipas parashikimeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

Të gjithë projektvendimet për miratimin e tarifave, përpara se të marrin formë përfundimtare nga ERRU, dërgohen për komente në shoqëritë UK dhe bashkitë përkatëse, si edhe tek Autoriteti i Konkurrencës.

Rritja e vazhdueshme e kostove kryesisht atyre të energjisë elektrike, të punës dhe të materialeve dikton akoma nevojën për mbështetjen e shoqërive UK me subvencione nga qeveria qendrore, deri sa gradualisht, nëpërmjet kostove efektive dhe planifikimit afatgjatë, të arrihet të mbulohen me të ardhura të gjitha kostot operationale në sektorin UK. Gjithsesi, nga të dhënat fillestare të reformës gjatë këtyre dy viteve të para duket se agregimi i shoqërive UK në shoqëri rajonale të formuara në zbatim të reformës në sektorin e ujit ka patur ndikim pozitiv në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të tyre dhe të sektorit në përgjithësi.

1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore

Gjatë vitit 2024, ERRU ishte palë në 3 procese gjyqësore civile dhe administrative, statusi i të cilave paraqitet si më poshtë:

1. L.B. - ERRU

Palë Paditëse: L.B

Palë e Paditur: ERRU

Objekti:

1. Shfuqizim i vendimit nr. 15, datë 25.03.2019 “Për zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës”;
2. Detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblimin me 12 muaj pagë pune, për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
3. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 3 muajve për mos respektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
4. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 2 muajve për mos respektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
5. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e një 15 ditësh-i për çdo vit vjetërsi në punë, konkretisht 9 vjet vjetërsi në punë, e barabartë me 4 paga e gjysmë shpërblim, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë.

Kjo çështje është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ende nuk e ka shqyrtuar çështjen.

2. A.G. - ERRU

Palë Paditëse: A.G

Palë e Paditur: ERRU

Objekti: Detyrimi i palës së paditur, ERRU, që të paguajë shpërblimin për vjetërsi në punë për periudhën 21.08.2006 deri më 03.08.2014, periudhë gjatë së cilës kam ushtruar detyrën e Anëtarit të KKRR në masën e 4 pagave mujore referuar pagës mujore në momentin e përfundimit të marrëdhënies së punës, e cila është 146,150 lekë.

Kjo çështje është ende në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

3. K. R. – ERRU

Palë Paditëse: K.R

Palë e Paditur: ERRU

Objekti: 1. Detyrimin e palës së paditur për të dëmshpërblyer paditësen me: i. Pagën e 1 viti për zgjidhje të kontratës pa shkaqe të justifikuara; ii. Pagën e 2 muajve për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës; iii. Pagën e 4 pesëmbëdhjetë ditëshave ose pagën e 2 muajve si shpërblim për vjetërsi në punë prej 4 vitesh; iv. Pagën e 2 muajve për mosrespektimin e afatit të njoftimit.
2. Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile.
3. Detyrimin e palës së paditur të paguajë shpenzimet gjyqësore.

Kjo çështje është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

1.4.4 Mbrojtja e Konsumatorëve

Mbrojtja e konsumatorit është një nga objektivat institucionalë më të rëndësishëm të rregullatorit për të siguruar që shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura të jenë të qëndrueshme, të sigurta dhe të përballueshme për konsumatorët.

Edhe në vitin 2024, në fokus të punës së ERRU-së, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit, ka qenë përmirësimi i standardeve të shërbimeve të ofruara në sektorin UK nëpërmjet instrumenteve rregullatore si seancat dëgjimore me publikun gjatë procesit të miratimit të tarifave, monitorimi i vazhdueshëm i treguesve të performancës, përmirësimi i mekanizmave të informimit si dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve.

VKM nr. 326, datë 29.05.2024, “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030”, në zbatim edhe të direktivave evropia ka

vendosur në qendër konsumatorin dhe synon fuqizimin e tyre për një rol aktiv në treg, duke ushtruar të drejtat dhe fuqinë e tyre të zgjedhjes së mirë informuar në blerjen e mallrave dhe të shërbimeve. ERRU, si institucion kontribuues në këtë dokument strategjik ka përcaktuar rëndësinë e mbrojtjes së konsumatorit në drejtim të zbatimit të të drejtave të konsumatorëve, zgjidhjes alternative dhe online të mosmarrëveshjeve, si dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve. Në këtë kuadër, objektivat e institucionit tonë janë fokusuar në rritjen e kontrollit ndaj shoqërive UK për zbatimin e legjislacionit ekzistues dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit në këtë sektor, si dhe në rritjen e transparencës ndaj konsumatorit për shërbimet UK e mekanizmave të ankimit.

Harmonizimi me Direktivën 2013/11/EU “Zgjidhja Alternative të Mosmarrëveshjeve” të Parlamentit Evropian ka qenë në fokusin e punës së ERRU-së për vitin 2024, si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për nën kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit” pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) të Bashkimit Evropian. Kontributi i këtij viti ka qenë mbi dokumentet e rëndësishme si Pozicioni Negociues – Grupi 2: Tregu i Brendshëm dhe draft Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, për periudhën 2025 – 2027.

Në kuadër të zhvillimit të shpejtë dhe të përhapur digjital, ERRU ka zhvilluar kanale të ndryshme informacioni për t’iu ofruar konsumatorëve akses sa më të lehtë në informacione e të dhëna që i përkasin sektorit të ujit. Si pjesë e angazhimit për transparencë dhe llogaridhënie në politikat e shpërndarjes së informacionit, ERRU ka përditësuar rregullisht faqen zyrtare me përmbajtje të re informacioni. Këtu përfshihen njoftimet në lidhje me vendimet e marra në ERRU, raporte të përditësuara së bashku me buletinet 3 mujore që mbulojnë të gjitha zhvillimet më të fundit të lajmeve dhe aktiviteteve të ERRU-së. Gjithashtu, ka përfshirë përdorimin e një sërë platformash digjitale si p.sh “Instagram”, “Facebook”, “Linkedin” për të shpërndarë informacion të përgjithshëm në lidhje me të drejtat e detyrimet, tarifat e konsumatorëve, si dhe standardet e cilësisë së shërbimit.

- **Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve**

Një nga mekanizmat kryesorë të mbrojtjes së konsumatorit është siguri që, nëpërmjet trajtimit të ankesave, konsumatorët të trajtohen në mënyrë të drejtë e të barabartë në zgjidhjen e ankesës së tyre.

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, Enti Rregullator i Ujit është hallka e dytë administrative për drejtimin dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve kundrejt shërbimeve UK. Fillimi i një procedure trajtimi ankese konsiderohet verifikimi nëse ankesa plotëson kriteret minimale formale dhe ligjore, dhe pasi konstatohet nëse ankesa që paraqitet për shqyrtim, përfshin një shoqëri të licencuar. Pasi analizohet dokumentacioni i vënë në dispozicion nga konsumatorët, ERRU adreson ankesën tek i licencuari për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit plotësues të nevojshëm që i shërbejnë procesit të trajtimit të ankesës dhe jep rekomandimet e duhura për zgjidhjen e saj. Gjithashtu, nëpërmjet shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, rregullatori evidenton problematikat që kanë shoqëritë UK në lidhje me ofrimin e shërbimit.

Pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorit, gjatë vitit 2024, janë depozituar 25 ankesa me shkresë zyrtare, të ardhura si nga konsumatorë familjarë dhe privatë nga Tirana, Durrësi, Vlora, Elbasani, Fieri, Gjirokastra, Vora etj. Gjatë këtij viti janë trajtuar dhe zgjidhur edhe ankesa të

ardhura nga konsumatorë publikë dhe ankesa të adresuara nga Avokati i Popullit. Për këto ankesa, ERRU ka vijuar me procedurat e komunikimit zyrtar me shoqëritë UK për të evidentuar mënyrën e trajtimit të ankesave nga shoqëria dhe respektimin e akteve nënligjore, të cilat rregullojnë marrëdhënien shoqëri UK - konsumator. Përveç ankesave të paraqitura në mënyrë zyrtare (shkresë zyrtare), ERRU ka vijuar komunikimin dhe ka ofruar asistencë për 12 ankesa të tjera për zgjidhjen e problemeve të tyre lidhur me shërbimet UK nëpërmjet konsultimeve verbale pranë zyrave të ERRU-së dhe kanaleve të komunikimit: e-mail; telefon; faqe zyrtare e ERRU-së në rubrikën “Dërgo një ankesë”.

Në vijim të njohjes së konsumatorëve dhe shoqërive UK për rolin ndërmjetësues që ka rregullatori për trajtimin e ankesave, orientimi dhe trajtimi i ankesave përgjatë vitit 2024 me verifikime në terren dhe me zhvillimin e takimeve me shoqëritë UK është kryer nëpërmjet strukturës së ngritur pranë ERRU-së për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve.

Natyra e ankesave për këtë vit ka qenë në katër kategori: “Faturimi Aforfe”, “Cilësia e Shërbimit të Ofruar nga Shoqëritë UK” ; “Zbatueshmëria e Kushteve të Kontratës për shërbime UK” si dhe “Të tjera”. Referuar tabelës së mëposhtme, nga totali i të gjithë ankesave, njëzet prej tyre kanë pasur një zgjidhje përfundimtare dhe të kënaqshme në favor të konsumatorit.

Tabela Nr. 4 Ankesat e trajtuara nga ERRU gjatë vitit 2024

Nr.	Objekti i Ankesës	Nr. Ankesave	Nr. Ankesave të Zgjidhura
1.	Faturimi Aforfe	11	3
2.	Zbatueshmëria e Kushteve të Kontratës	9	5
3.	Cilësia e Shërbimit	8	6
4.	Të tjera	9	6
TOTALI		37	20

Ankesat e paraqitura në ERRU me objekt “Anulim i Faturimit Aforfe” vijnë të jenë pjesë e natyrës së ankesave që i drejtohen ERRU-së. Rastet e faturimit aforfe ku konsumatorët faturohen më shumë se norma e konsumit mujor për person, e parashikuar në rastet kur konsumatori nuk ka ujëmatës, vijnë të jenë objekt i ankesave pranë ERRU. Nga ankesat e këtij viti janë evidentuar raste problematike të faturimit aforfe për vite të tëra për konsumatorë, të cilët nuk jetojnë prej vitesh në banesat e tyre. Për këto lloj ankesash, ERRU ka rekomanduar hartimin e planeve të veprimit konkrete nga ana e shoqërive UK për eliminimin e këtij lloj faturimi dhe evidentimin e saktë të konsumatorëve aktivë dhe jo aktivë. Kontrata për shërbimet UK përcakton të drejtat dhe detyrimet e marrëdhënies konsumator – shoqëri UK, ndaj respektimi i tyre është kusht kryesor për sigurimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit. “Respektimi dhe Zbatueshmëria e të Drejtave dhe Detyrimeve”, të përcaktuara në kontratën për shërbime ujësjellës kanalizime ka qenë objekt ankimi për nëntë ankesa të tjera të ardhura pranë ERRU-së, për të cilat pesë prej tyre kanë gjetur një zgjidhje të kënaqshme për konsumatorët.

Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i konsumatorit për të patur një shërbim UK sa më cilësor dhe problematikat e hasura për zgjidhje sa më të shpejtë dhe efeciente të këtyre lloj ankesave ka sjellë një rritje të ankesave për “Cilësinë e Ofruar e Shërbimit” dhe “Të tjera”. Objektet e ankimit të këtyre lloj ankesave kanë qenë të fokusuara në probleme teknike për të cilat shoqëritë UK nuk kanë dhënë asnjë zgjidhje ose nuk i janë përgjigjur konsumatorëve. Ndaj për këto lloj ankesash ka qenë i nevojshëm

verifikimi në terren nga ana ERRU-së, në zbatim të strukturës së zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes për të garantuar angazhimin e shoqërive UK.

1.4.5 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK

Raporti Vjetor i Performancës së Sektorit UK paraqet ecurinë e performancës së këtij sektori krahasuar me vitin paraardhës ku pasqyrohen problematikat për sektorin në tërësi, si dhe për secilën shoqëri UK në veçanti. Gjithashtu, në këtë raport jepen dhe rekomandimet përkatëse në nivel strategjik për përmirësimin e performancës së sektorit në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

ERRU i kushton një rëndësi të veçantë monitorimit dhe vlerësimit të performancës së operatorëve UK dhe sektorit në tërësi duke synuar nxitjen e përmirësimit të performancës së tij, referuar cilësisë së shërbimeve të ofruara për konsumatorët edhe qëndrueshmërisë financiare të vetë sektorit. Kjo arrihet duke kryer një vlerësim korrekt të performancës së çdo operatori dhe vendosjen e objektivave sfiduese dhe të arritshme, shoqëruar me plane veprimi për arritjen e tyre.

ERRU grumbullon të dhënat sipas formatit të miratuar të bazës së të dhënave, të cilat përdoren edhe për hartimin e Raportit Vjetor 2024. Në përputhje me planet e miratuara dhe kur vihen re problematika, ERRU kryen gjithashtu monitorime në terren në shoqëritë UK për një vlerësim real të performancës, si dhe me njohjen e vështirësive dhe problematikave që hasin shoqëritë UK.

Viti 2024 është viti i dytë i zbatimit të reformës dhe mund të konsiderohet se shoqëritë tashmë janë drejt konsolidimit të tyre. ERRU ka ndjekur me përparësi procesin e mbajtjes dhe raportimit të të dhënave nga shoqëritë UK duke komunikuar intensivisht me to në mbështetje të këtij procesi. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2024 janë realizuar takime dhe vizita monitoruese në vend me të gjitha shoqëritë UK rajonale të krijuara, të cilat kanë patur në thelb mbarëvajtjen e operimit të tyre në zbatim të ligjit të ERRU-së nr. 8102 dhe vendimit nr.302, datë 11.05.2022 “Për Riorganizimin e Sektorit” në drejtim të licencimit, problematikave mbi nivelet e ndryshme tarifore, pagesat rregullatore të tyre, pengesat në përmirësimin e performancës së shoqërive rajonale dhe situatës së tyre financiare si rezultat i ndryshimeve në sektor.

Gjithashtu, një nga problematikat që konstatohet në mënyrë të vazhdueshme është saktësia e të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK. Monitorimi nga ERRU, me ndryshimet sipas reformës, ku qeveria qendrore ka 51% të aksioneve të shoqërive rajonale UK (SKP), merr një rëndësi të veçantë për objektivitetin dhe transparencën e vlerësimit të performancës së sektorit UK.

Kjo situatë pritet të përmirësohet me ngritjen e Sistemit të Integruar të të Dhënave dhe Treguesit Kryesorë të Performancës (IPIS), që mbahen dhe raportohen nga shoqëritë UK, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet ERRU dhe AKUK, të mbështetur nga Banka Botërore.

Ky sistem pritet të ketë impakt pozitiv në zgjidhjen përfundimtare të problematikës së raportimit të të dhënave të sakta dhe të besueshme.

1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së

Viti 2024 ka qenë një vit frytdhënës në drejtim të marrëdhënieve të ERRU me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, në vijim të zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara rishtaz si dhe ato të mëparshme. Enti Rregullator i Ujit ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme si brenda dhe jashtë vendit, duke ndjekur me interes zhvillimet më të fundit inovative në sektorin e ujit me qëllim për të përthithur praktikat më të mira. Gjithashtu, stafi organizativ është bërë pjesë e seminareve e trajnimeve, si dhe ka qenë pjesë e grupeve trajnuese të stafëve menaxhuese të shoqërive UK.

1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare

1.5.1.1 Me Kuvendin e Shqipërisë

Në përmbushje të detyrimit të ngarkuar me ligj, marrëdhënia e ERRU me Kuvendin e Shqipërisë është fokusuar në raportimin periodik të situatës në sektorin UK si dhe nivelit të zbatimit të rekomandimeve në Rezolutë, raportimin në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit (KVPTM) si dhe raportimit në Kuvendin e Shqipërisë mbi veprimtarinë e institucionit për vitin paraardhës. Në qershor të vitit 2024, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rezolutën me vlerësimin e veprimtarisë së ERRU me 13 rekomandime për t'i zbatuar gjatë këtij viti.

Në kuadër të negociatave me Bashkimin Evropian (BE), ERRU ishte pjesë e tryezës së organizuar nga Kuvendi me drejtuesit e institucioneve të pavarura, në të cilën u kërkuar kontributi i tyre në realizimin e funksionit mbikëqyrës të organit legjislativ.

Edhe në fund të vitit, ERRU ishte pjesë e një tjetër takimi teknik me institucionet e pavarura në kuadër të Projektit për Edukimin Qytetar (PACEP), financuar Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Një ndër objektivat kryesorë të projektit është fuqizimi dhe mbështetja e mbikëqyrjes parlamentare, ndërsa zbatimi i këtij komponenti do të koordinohet nga zyra në Shqipëri e Global Partners Governance (GPG). Takimi kishte qëllim prezantimin e projektit dhe mekanizmat bashkëpunues që do të ofrojnë.

1.5.1.2 Me AKUK (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve)

Në kuadër të dy marrëveshjeve të lidhura së fundmi me AKUK mbi “Mbi Raportimin e të Dhënave të Shoqërive UK pranë Sistemit të Integruar të Informacionit të Performancës (IPIS)”, si dhe “Hartimi dhe Miratimi i Modelit të Planeve Pesëvjeçare të Biznesit për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve”, ERRU ka punuar për zbatimin e tyre, si dhe për të çuar përpara reformën së sektorin ujësjellës kanalizime. Brenda vitit 2025 pritet të publikojë modelin e planeve të biznesit 5-vjeçare për shoqëritë UK. Po ashtu, përgjatë gjithë vitit ka asistuar dhe ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me AKUK për propozimet e shoqërive rajonale për tarifa të reja, si aksionare kryesore e tyre.

1.5.1.2.1 Me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)

Në vijim të marrëdhënieve ndërinstitucionale në sektorin e ujit, ERRU ka bashkëpunuar edhe me AMBU duke u bërë pjesë e aktiviteteve dhe takimeve konsultative. Në një prej takimeve të organizuara nga AMBU, ERRU ka dhënë kontributin e tij për të mbështetur dhe orientuar ujësjellësit rajonalë në formalizimin e të gjithë burimeve ujore që ata përdorin. Po ashtu, edhe gjatë këtij viti ka vijuar puna

për përgatitjen e politikave që sigurojnë qasje të barabartë në FU dhe KUN për të gjithë, në kuadër të projektit të asistuar nga Komisioni Ekonomik i BE dhe OBSH. Në prill, ERRU mori pjesë në aktivitetin për avancimin e përgatitjes së “Kartelës së Rezultateve për Qasje të Barabartë”, një instrument për të mbështetur qeverinë, institucionet dhe palët e interesuar në vlerësimin e progresit në sigurimin e aksesit të barabartë në ujë dhe kanalizime. Po ashtu, ERRU është ftuar të japë kontributin e tij në takimet e grupit tematik “Burimet Ujore” si dhe takimit në kuadër të zbatimit të projektit “EU4Rivers” që sinjalizon nisjen e punës për vlerësimin e Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SKMIBU).

1.5.1.3 Me Autoritetin e Konkurrencës

Në vijim të zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me Autoritetin e Konkurrencës, ERRU edhe përgjatë vitit 2024 ka vijuar bashkëpunimin me këtë institucion me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive si dhe garantimin e mbrojtjes së interesave publike në sektorin e ujit. ERRU ka kërkuar vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për gjashtë projektvendime për miratimin e nivelit të ri tarifor për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. Konkretisht për gjashtë shoqëritë rajonale: UK Lezhë, Fier, Durrës, Shkodër, Pogradec dhe Gjirokastër.

1.5.1.4 Me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Për të forcuar më tej mekanizmat e transparencës në zbatim të legjislacionit “Për të Drejtën e Informimit”, gjatë vitit 2024 ERRU përmes koordinatorit të tij ka qenë në kontakt të vazhdueshëm dhe është përfshirë në disa tryeza dhe organizime nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP). E tillë ishte Konferenca VI Kombëtare Për të drejtën e Informimit, “Ndërtimi i besimit – Promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit” ku u trajtua transparenca e autoriteteve publike dhe zbatueshmëria e ligjit për të drejtën për informim. Po ashtu, edhe pjesëmarrja në Edicionin e XV të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit “Fuqizimi i individëve përmes aksesit në informacion: Sigurimi i Transparencës dhe Gjithëpërfshirës në një botë të ndërlidhur”.

1.5.1.5 Me Akademinë e Shkencave

Studimet dhe kërkimet shkencore në fushën e ujërave kanë vënë në kontakt Entin Rregullator të Ujit me Akademinë e Shkencave. Në vitin 2024, ERRU mori pjesë në Konferencën e parë Kombëtare për ujërat me temë: “Gjeoinxhinieria e Ujërave Sipërfaqësore dhe Nëntokësore në Republikën e Shqipërisë - Alternativat për ruajtjen dhe miradministrimin e tyre” duke u prezantuar me punimin “Parimet e vendosjes së tarifave në Evropë dhe Shqipëri”. Qëllimi final i kësaj konference shkencore ishte të bashkojë dhe të unifikojë opinionet dhe qëndrimet e institucioneve shtetërore dhe shkencore si dhe të promovojë lidhjen midis studimeve akademike dhe përdoruesve të ujit.

1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

Një ndër prioritetet e ERRU-së mbetet përfaqësimi aktiv dhe dinjitoz i punës së rregullatorit në aktivitetet rajonale ballkanike dhe ndërkombëtare me qëllim për t’u njohur me qasje të reja rregullatore dhe përthithjen e përvojave e modeleve më të mira. Gjatë vitit 2024 ka ndjekur me interes seminarët e konferencat e organizuara nga organizatat me të cilat bashkëpunon duke u njohur me zhvillimet kryesore në lidhje me ujin.

1.5.2.1 ERRU Anëtare e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare

Si anëtarë me të drejta të plota e **Shoqatës Evropiane të Rregullatorëve të Ujit** (WAREG) prej dhjetë vitesh, ERRU ka marrë pjesë në tre mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të organizuara në vende të ndryshme të Evropës. Në prill 2024 u zhvillua *Asambleja e 31-të*, e bashkë me të edhe Konferenca mbi Qëndrueshmërinë e Sektorit të Ujit në të cilën u bënë bashkë shumë institucione të Bashkimit Evropian, rregullatorë dhe aktorë të tjerë interesi për të promovuar qëndrueshmërinë e sektorit të ujit dhe inkurajuar investimet në sektor. Në qershor 2024 u zhvillua *mbledhja e 32-të e Asamblesë*, ku çdo anëtar i WAREG, prezent dhe online, prezantoi barrierat kryesore me të cilat përballlet rregullatori i ujit, prioritetet kyçe për qëndrueshmërinë financiare të sektorit UK dhe zbatimin e direktivave Evropiane për ujërat. Në dhjetor 2024, në mbledhjen e fundit të asamblesë, u zgjodh bordi i ri drejtues si dhe u prezantua dokumenti i WAREG “Nga efikasiteti i energjisë të neutralitetit klimatik në sektorin e ujit”.

Duke qenë pjesë e **Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë** (NER), të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim në Evropë (OECD) ERRU ka marrë pjesë në Takimin e 23-të të tij në të cilin u diskutua qeverisja e rregullatorëve në kontekste të ndryshme; Rregullatorët si komunikues si dhe Drafti i Parimeve të Praktikave më të mira mbi lejet dhe licencimet.

Si anëtare e **Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit** (IWA), ERRU ka marrë pjesë në disa organizime siç ishte Konferenca dhe Forumi i Ujit të Danubit në Rumani ku rregullatorë të shumtë nga e gjithë bota sollën në tryezën e diskutimeve zhvillimet më të fundit të shërbimeve rregullatorë si dhe diskutuan mbi forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave me qëllim fuqizimin institucional të tyre.

1.5.2.2 Bashkëpunimi me Donatorë dhe Aktorë Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë

Në listën e donatorëve kryesorë që kontribuojnë në fushën e ujit është **Banka Botërore** (BB). Në kuadër të Projektit të Modernizimit të Sektorit të Ujit, ERRU ka zhvilluar takime me përfaqësues nga BB dhe konsulentë të huaj, të kontraktuar për të mbështetur me asistencë zbatimin e programit. Diskutimet janë fokusuar në disa aspekte të zbatimit të metodologjisë së caktimit të tarifave në kushtet e reformës së agregimit si dhe hartimin e planeve të biznesit për shoqëritë UK.

ERRU ka përfituar nga programi **TAIEX i Komisionit Evropian**, instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit të Komisionit Evropian. Nën koordinimin e WAREG, në nëntor të 2024 u zhvillua seminari i radhës, i cili trajtoi çështjen e Direktivës Evropiane të Ujit të Pijshëm, roli i rregullatorit në monitorimin e efikasitetit dhe investimeve, në hartimin e Treguesve Kryesorë të Performancës, monitorimin e tyre e të tjera.

Një tjetër program nga i cili përfiton ERRU dhe zbatohet po nga WAREG është Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve Rregullatore (KEP), i cili financohet nga **Banka Evropiane e Investimeve** (CEI) dhe vjen në mbështetje të procesit të integritetit evropian. Në shkurt u zhvillua seminari i fundit, i një cikli seminaresh të nisura që në vitin 2023, ku ERRU mori pjesë me një prezantim mbi situatën dhe sfidat rregullatore.

Gjatë vitit 2024, ERRU ka marrë pjesë në një tjetër projekt të Bashkimit Evropian, **“IPA Crosswater”** me fokus *“Trajtimi i Ujërave të Ndotura: Projektimi i procesit dhe Menaxhimi i Rikuperimit të tyre”* si

kontribuues me një prezantim mbi situatën e ujërave të ndotura në vend, parë nga këndvështrimi rregullator.

Bashkëpunimi i ngushtë me **Shoqatën Ujësjellës Kanalizime të Shqipërisë (SHUKALB)** ka vijuar edhe në vitin 2024 me pjesëmarrjen dhe kontributin në Konferencën dhe Ekspozitën Vjetore të organizuar në Kosovë me titull: *“Reforma në sektorin e ujit: Përmbushja e kuadrit rregullator dhe ndikimi në performancë”*. Konferenca solli edhe shumë takime me synimin për të nxitur një qasje të koordinuar për zhvillimin e kapaciteteve në fushën e ujërave mes aktorëve kombëtarë dhe rajonalë.

Një tjetër konferencë e organizuar nga **Veolia dhe nga SHUKALB** ishte ajo për *“Menaxhimin e sektorit të ujit, ndërtimi i kapaciteteve dhe mundësitë e financimit”*, në të cilën ERRU u bë pjesë e saj krahas përfaqësuesve nga qeveria, rregullatorët, shoqëritë UK dhe organizata ndërkombëtare me një prezantim mbi kuadrin ligjor dhe përmirësimet në metodologjinë e tarifave.

Gjatë vitit 2024, ERRU ka kontribuar me stafin e saj profesional në ciklin e trajnimeve të **Programit D – Leap “Menaxhimi i aseteve”**, nën organizimin e SHUKALB dhe mbështetjen e Partneritetit të Danubit. Përfaqësues nga Enti Rregullator i Ujit moderuan në tri ditë trajnime mbi Menaxhimin e Aseteve, Inventarin e Aseteve dhe Sistemet e Menaxhimit të të Dhënave duke angazhuar stafet e shoqërive UK në ushtrime praktike për të zbuluar njohuritë e tyre.

Në vitin 2024, ERRU ka bashkëpunuar edhe me homologun e saj në Bosnje-Hercegovinë. E ftuar nga **Asociacioni për Mbrojtjen e Ujit dhe Mjedisit “Rrjeti Aquasan në Bosnje – Hercegovinë”**, ERRU mori pjesë në konferencën e pestë ndërkombëtare me titull *“Shërbimet efiçente dhe të qëndrueshme të ujit”*. Fokusi i konferencës u vendos tek institucionet, organizatat dhe ekspertët, roli e përgjegjësia e tyre në procesin e reformës së sektorit të shërbimeve të ujit.

1.5.2.3 Marrëdhëniet bilaterale

Në kuadër të bashkëpunimit me Autoritetin Rregullator të Ujit të Kosovës (ARRU), gjatë vitit 2024 ERRU ka zhvilluar takime pune për të diskutuar qasjet e dy rregullatorëve mbi Metodologjinë e Tarifave, Monitorimin e Performancës së Shoqërive UK si dhe Trajtimit të Ankesave të Konsumatorëve. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencave midis dy rregullatorëve mbi çështje të caktuara të sektorit të ujit në vendet respektive shërbeu si ndihmesë në momentin kur Shqipëria ishte e përfshirë në reformën agregimit të sektorit, një formë organizimi që Kosova e ka zbatuar që në fillimet e saj dhe ka një përvojë të konsoliduar në këtë drejtim.

1.5.2.4 Artikuj studimorë, Botimet

Gjatë vitit 2024, ERRU ka botuar një artikull studimor *“Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Ujore dhe Roli i Rregullatorit të Sektorit UK”*, i cili vjen pas miratimit të ligjit për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, ku sanksionohet kuadri ligjor që garanton politikat ekzekutive në zbatim të parimeve të pasurisë ujore në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si një nga kushtet e *“acquis communautaire”* që duhet të përmbushë dhe vendi ynë. Në artikullin e ERRU analizohen parimet bazë të këtij ligji e zbatimi i tyre në Shqipëri dhe paralelisht me to, roli që luan rregullatori në respektimin e tyre me anë të instrumenteve ligjore në dispozicion. Artikulli *“Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve*

Ujore dhe Roli i Rregullatorit të Sektorit UK” është publikuar në faqen zyrtare dhe në të gjitha rrjetet sociale të ERRU, si dhe në buletin elektronik të përmuajshëm të Shoqatës Ujësjellës Kanalizime të Shqipërisë (SHUKALB).

1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median

Duke qenë se frytet e para të reformës në sektorin e ujit u panë në vitin 2024, puna e Entit Rregullator të Ujit ka patur një prezencë të shtuar në media. Si për vendimmarrjet e Komisionit Kombëtar Rregullator, ashtu edhe për pikëpyetjet mbi atë se çfarë do të ndodhë tanimë me sektorin. ERRU ka monitoruar me kujdes dhe i është përgjigjur pozitivisht ftesave mediatike për të folur mbi situatën apo problematikat në sektorin UK, si dhe është bërë pjesë e paneleve dhe dokumentarëve mbi çështjet e ujit.

Faqja zyrtare e ERRU vijon të mbetet shtylla kryesore në të cilën përditësohen informacionet më të rëndësishme për qytetarët, që nga vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator, botimet, analizat e deri tek dëgjuesat e kryera në shoqëritë ujësjellës pas aplikimeve për tarifa të reja. Të gjitha këto, herë pas here janë pasqyruar në media, kryesisht ato online.

Në lidhje me komunikimin dhe transparencës kundrejt qytetarëve, në vitin 2024 ka patur dy kërkesa për informacion, të cilat kanë marrë përgjigje brenda afateve zyrtare. Sakaq, në faqen e ERRU është përditësuar vazhdimisht regjistri i “Kërkesave dhe Përgjigjeve”, ndërsa të gjitha informacionet mund të gjenden tek “Programi i Transparencës”, siç parashikon detyrimi ligjor për informimin e publikut. Transparenca dhe llogaridhënia ndaj publikut vijon të mbetet fokus në punën e ERRU duke respektuar me përpikëri dhe publikuar në kohën e duhur në faqen e website erru.al të gjitha vendimet, aktet nënligjore e çdo informacion në interes të konsumatorëve. Për të qenë më pranë konsumatorëve, përdorues të rrjeteve sociale të cilët duan të njihen me veprimtarinë e ERRU, institucion publikon në rrjetet sociale “LinkedIn”, “Facebook” dhe “Instagram” informacionet dhe aktivitetet kryesore.

Risi e vitit 2024 është hartimi dhe publikimi Buletinit Informativ me bazë 3-mujore, në të cilin bëhet një përmbledhje e punës me vendimmarrjet e KKRR, situatën e licencimeve dhe tarifave, publikimin e analizave, botimeve dhe çdo event i ku ERRU merr pjesë në këtë hark kohor.

1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

1.7.1 Të Ardhurat

Pagesat rregullatore të operatorëve që operojnë në sektorin UK, pagesat për licencimin e tyre dhe donacionet përbëjnë burimin e vetëm të financimit në ERRU, sikurse përcaktohet në ligjin 8102 datë 28.03.1996 “Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, i ndryshuar. Enti Rregullator i Ujit ka nënshkruar kontrata me operatorët ku është përcaktuar tarifa rregullatore vjetore dhe afatet e likuidimit.

Detyrimi vjetor i pagesave rregullatore për vitin 2024, mbështetur në kontratat dhe aneks aktmarrëveshjet me 14 Subjektet me Kompetenca të Përbashkëta SKP dhe 2 shoqërive UK, është në shumën 81 160 340 lekë. Detyrimi për pagesë rregullatore i mbartur nga vitet paraardhëse është 25 593 323 lekë.

Arkëtimet totale të ERRU të realizuara gjatë vitit 2024 janë në shumën totale 71 123 611 lekë, nga të cilat për pagesa rregullatore janë 70 433 611 lekë dhe për tarifa licencimi janë 690 000 lekë, detajuar më poshtë në Tabelën 5.

Tabela Nr. 5 Realizimi i Arkëtimeve Sipas Zërave

Nr.	Arkëtime gjatë Vitit 2024	Vlera/ lekë
1	Nga pagesat rregullatore të prapambetura	24 176 323
2	Nga pagesat rregullatore të vitit 2024	46 257 288
3	Nga pagesat e licencimit	690 000
Totali		71 123 611

Për mbledhjen e detyrimeve të papaguara, shoqërive UK u është kërkuar përmbushja e detyrimit si dhe janë nënshkruar aktmarrëveshje për lehtësimin e shlyerjes me këste me shoqëritë e reja rajonale të krijuara sipas reformës, të cilat sipas përcaktimeve të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 janë të detyruara të mbartin dhe të shlyejnë detyrimet kontraktuale të ish-shoqërive UK para reformës.

Shlyerja e detyrimeve të pagesës ndaj ERRU-së për licencimin ka qenë e rregullt si detyrim paraprak i shoqërive UK për t'u licencuar. Likuiditetet në vitin 2024 garantojnë tërësisht mbështetjen financiare për ushtrimin e aktivitetit të ERRU për vitin 2025, duke mbuluar tërësisht shpenzimet e parashikuara vjetore.

1.7.2 Shpenzimet Operative


Administrimi i vlerave materiale e monetare në ERRU kryhet në përputhje të plotë me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik" dhe Rregullores së Brendshme të ERRU "Për Menaxhimin e Aktiveve".

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së propozohet nga ajo vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura", i ndryshuar.

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së për vitin 2024 është miratuar me VKM nr. 702, datë 06.12.2023, "Për Miratimin e Planit të Shpenzimeve Operative për vitin 2024, për Entin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura". Fondi i miratuar për shpenzimet operative është 71 217 100 lekë.

KKRR, me vendimin nr.1, datë 10.01.2024, ka detajuar planin vjetor të miratuar nga Këshilli i Ministrave në artikuj të shpenzimeve në përputhje me nevojat e domosdoshme për të garantuar mbështetjen logjistike për përmbushjen e objektivave vjetorë të ERRU-së, zhvillimin e veprimtarive të parashikuara dhe funksionimin normal të veprimtarisë së përditshme.

Plani vjetor është detajuar në katër zëra kryesorë: paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shërbime e furniturë dhe investime sipas raporteve në përqindje që paraqiten në Grafikut 1, si më poshtë:




Grafiku 1. Struktura e Planit të Shpenzimeve Operative të Vitit 2024

Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të Entit gjatë vitit 2024 janë në shumën 60 577 152 lekë, ose 85 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative. Realizmi i shpenzimeve në zëra dhe në vlera paraqiten si më poshtë:

- 41 198 065 lekë / 87%, shpenzime për pagat e punonjësve;
- 6 516 361 lekë / 87% shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore;
- 10 882 270 lekë / 78% shpenzime për shërbime e furniturë;
- 1 980 456 lekë / 79 % shpenzime për investime.

Plani i miratuar i shpenzimeve operative të ERRU krahasuar me shpenzimet e realizuara paraqitet ne vijim në formë grafike:



Grafiku 2. Plani i Shpenzimeve të Miratuara nga KM krahasuar me Shpenzimet e Realizuara

Shpenzimet kanë rezultuar më të vogla se planifikimi, për shkak të shpenzimeve të parealizuara për shpenzimet për pagat dhe sigurimet për punonjësit, si dhe nga disa kursime për shërbime furniturë dhe investime.

2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2024

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2024, referuar Raportit të Aktivitetit të Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2023, përcakton angazhimet në drejtim të institucionit të ERRU-së për vitin 2024, realizimi i të cilave rezulton si më poshtë:

- 1. Në kuadër të reformës në sektorin UK, të ofrojë asistencën e nevojshme për shoqëritë rajonale në lidhje me problematikat që në mjaft raste pritet të hasen nga propozimet e tarifave të reja duke zbatuar metodologjinë e re të tarifave të shërbimeve UK.***

ERRU ka vijuar të luajë një rol të rëndësishëm në drejtim të problematikave të hasura nga shoqëritë UK rajonale gjatë propozimeve për tarifa të reja duke iu dhënë asistencën e nevojshme në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 8102 të ERRU-së dhe në Metodologjinë e re të Tarifave, miratuar me vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021. Gjatë vitit 2024 kanë aplikuar për nivel të ri tarifor 6 shoqëri UK rajonale, përkatësisht: UKR Pogradec, UKR Gjirokastrë, UKR Shkodër, UKR Korçë, UKR Elbasan dhe UKR Berat. Në vijim të zbatimit të metodologjisë së re të tarifave, për këto shoqëri shpesh herë ka qenë e nevojshme asistencë teknike nga ERRU mbi plotësimin e plotë dhe të saktë të dokumentacionit të kërkuar, në mënyrë që të përmbyllnin me sukses aplikimin e tyre për nivel të ri tarifor. Deri në mbyllje të vitit 2024, ERRU ka marrë vendimet përkatëse për 3 shoqëri si: UKR Pogradec, UKR Gjirokastrë dhe UKR Shkodër, ndërsa 3 shoqëritë e tjera janë në fazën e analizës tekniko ekonomike.

- 2. Në bashkëpunim me AKUK, të kontribuojë në ngritjen sa më shpejt të Sistemit të Integruar të të Dhënave dhe Treguesve Kryesorë të Performancës në kuadër të marrëveshjes “Për Raportimin e të Dhënave të Shoqërive UK pranë Sistemit të Integruar të Informacionit të Performancës (IPIS)”, i cili do të përdoret nga të dyja palët.***

Në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit me AKUK të nënshkruar në Nëntor të vitit 2023 mbi “Raportimin e të Dhënave të Shoqërive UK pranë Sistemit të Integruar të Informacionit të Performancës (IPIS)”, gjatë vitit 2024 ERRU ka luajtur një rol aktiv duke identifikuar dhe propozuar të dhënat e nevojshme që duhen patur në konsideratë për t’u përfshirë në sistemin (IPIS), të cilat i ka përcjellë tek koordinatori i projektit pranë AKUK. IPIS konsiston në krijimin dhe përdorimin nga të dy palët të një sistemi të integruar mbi të dhënat dhe treguesit kryesorë të performancës, të mbledhura nga shoqëritë UK dhe pritet të jetë një hap shumë i rëndësishëm në drejtim të unifikimit të të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK, si dhe të rritjes së saktësisë së tyre. Ky projekt, nisur nga informacioni që kemi nga AKUK, si institucioni përgjegjës për ndjekjen e këtij procesi pritet të përmbillet dhe të jetë në përdorim brenda vitit 2025.

3. Në bashkëpunim me AKUK, të marrë iniciativën për ndryshimet e nevojshme legislative për sigurinë e objekteve të sistemeve të FU që konsiderohen si objekte të rëndësishme të veçantë, për të mundësuar zgjidhje alternative që reduktojnë kostot mjaft të larta të rojeve duke kërkuar zgjidhje alternative teknike përmes sistemeve digjitale të teknologjisë së informacionit.

ERRU, në funksion të uljes së kostove të stafit, ka propozuar në mënyrë të vazhdueshme nevojën për rishikimin e mundësive me zgjidhje alternative me kosto më të ulëta të sigurisë së objekteve të rëndësishme të veçantë të sistemeve të FU dhe KUN, si depot, stacionet e pompimit, pusët, në vend të shërbimit me roje 24/7. Në këtë kontekst është propozuar që të merret në konsideratë alternativa e sigurisë së këtyre objekteve me kamera survejimi dhe masa të tjera teknike, pa cenuar sigurinë e tyre nga ndonjë ndërhyrje e mundshme nga jashtë.

Në vijim të këtij propozimi, nga ana e AKUK jemi informuar se ka filluar investimi në këtë drejtim, fillimisht me anë të dy projekteve pilot për dy shoqëri rajonale, përkatësisht: UKR Fier dhe UKR Durrës. Në të dyja këto shoqëri ka filluar puna për rrethimin e depove që kanë patur mangësi në këtë drejtim, pajisja dhe monitorimi i tyre me kamera 24/7 dhe ndërtimi i sallave të monitorimit për të dy këto shoqëri. Konkretisht, në Shoqërinë Rajonale UKR Fier po investohet në rreth 160 depo dhe në Shoqërinë UKR Durrës po investohet në rreth 60 depo. Pritet që ky investim të ndikojë drejtpërdrejt në uljen e kostove të stafit, pasi në disa raste shërbimi me roje realizohet me punonjësit e vetë shoqërisë duke kërkuar kështu një numër më të lartë stafi. Në disa raste të tjera, ky shërbim realizohet me nën kontraktorë duke rritur akoma më tej kostot e shoqërive UK.

4. Gjatë monitorimeve që kryen, t'i kushtojë rëndësi të veçantë monitorimit të cilësisë dhe sasisë së ujit, kërkesë e cila theksohet edhe në raport progresin e KE-së dhe që ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës dhe uljen e shpenzimeve të qytetarëve.

ERRU, i kushton një vëmendje të veçantë monitorimit të cilësisë dhe sasisë së ujit, i cili ka ndikim të ndjeshëm në jetën e përditshme të konsumatorëve. Për këtë arsye, ERRU analizon treguesin e Ujit Pa të Ardhura (UPA) si një tregues shumë i rëndësishëm, për të cilin harton edhe një raport vjetor të veçantë ku paraqitet situata e UPA për të gjithë sektorin në tërësi dhe për secilën shoqëri UK në veçanti.

Reduktimi i UPA ndikon direkt në kohëzgjatjen e furnizimit me ujë, uljen e kostove dhe rritjen e efikasitetit për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me ujë për konsumatorët.

Gjithashtu, ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka bashkëpunuar me aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë duke qenë pjesë e tryezave ku janë diskutuar mundësitë për zbatimin e praktikave më të mira në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të KE-së. Në këto takime, ERRU ka dhënë rekomandimet përkatëse të domosdoshme për t'u mbajtur në konsideratë nga organet përgjegjëse.

5. Në vijim të reformës, të kërkojë nga shoqëritë rajonale pajisjen e të gjithë klientëve me matës, si një nga objektivat kryesore të këtyre shoqërive me ndikim direkt në përmirësimin dhe lehtësimin e kërkesës për ujë, uljes së shpërdorimeve të mbi konsumit të tij, në mënyrë që t'i jepet fund abuzimit nga klientët e pa përgjegjshëm.

Niveli i Matjes është një ndër treguesit më të rëndësishëm të analizuar nga ERRU, pasi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit të ofruar për konsumatorët, si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë, duke ndikuar në përmirësimin apo përkeqësimin e tyre.

ERRU ka theksuar vazhdimisht nevojën e instalimit të matësve në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë, e cila ka qenë pjesë e rekomandimeve edhe gjatë vitit 2024, sidomos për shoqëritë që kanë aplikuar për nivel të ri tarifor. Në çdo rast janë vendosur objektiva agresivë në drejtim të rritjes së nivelit të matjes, të pasqyruara si më poshtë në tabelën nr. 6. Në këtë kontekst, ERRU i ka rekomanduar shoqërive UK se duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë pajisjes 100% të konsumatorëve me matës në mënyrë që konsumatorët të paguajnë volumn real të ujit të konsumuar, por edhe për faktin se faturimi aforfe lë hapësirë për shpërdorimin e ujit nga konsumatorët për ujitje, veçanërisht ato të shtëpive private dhe zonave rurale, e cila jep më pas impakt negativ edhe në treguesin tjetër, Uji Pa të Ardhura.

Tabela Nr. 6, Treguesi i Nivelit të Matjes aktual dhe ai i vendosur nga ERRU krahasuar me objektivin e vendosur nga vetë shoqëritë UK.

Nr.	Shoqëria	Treguesi Niveli i Matjes, Viti bazë (në %)	Objektivi i Shoqërisë Niveli i Matjes , (në %)	Objektivi i vendosur nga ERRU Niveli i Matjes (në %)
1	UKR Lezhë	69	75	75
2	UKR Fier	80	83	85
3	UKR Durrës	78	99	99
4	UKR Pogradec	88	100	100
5	UKR Gjirokastrë	67	85	90
6	UKR Shkodër	75	84	90

*** Për UKR Lezhë objektivi i vendosur është deri në fund të vitit 2025, ndërsa për shoqëritë e tjera objektivi i vendosur është deri në fund të vitit 2027 referuar periudhës rregullatore të vendosur për secilën shoqëri.**

Referuar tabelës nr.6 të mësipërme, vihet re qartazi se nga ana ERRU janë vendosur objektiva agresivë në drejtim të rritjes së nivelit të matjes, por gjithashtu vihet re se edhe nga vetë shoqëritë UK rajonale ky tregues është parashikuar ndjeshëm i përmirësuar. Kjo si rezultat i investimeve të parashikuara në zonat përkatëse të shërbimit, ku pajisja e të gjithë klientëve me matës është një ndër objektivat kryesorë për secilën nga këto shoqëri.

6. Të vijojë punën për krijimin e mekanizmave informues për rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve në drejtim të cilësisë së shërbimit UK të ofruar nga shoqëritë, si dhe njohjes së të drejtave dhe detyrimeve të palëve.

Krijimi i mekanizmave për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve është një nga objektivat kryesorë institucionalë të Entit Rregullator të Ujit, duke siguruar kështu rritjen e rolit të konsumatorit në kërkesën për ofrim sa më cilësor të shërbimit UK, si dhe nga ana tjetër, dhënien e vëmendjes së duhur sektorit të ujit në kushtet e sotme të ndryshimeve klimaterike.

Duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë dhe të përhapur digjital, ERRU ka zhvilluar kanale të ndryshme informacioni për t'i ofruar konsumatorëve akses sa më të lehtë në informacione e të dhëna që i përkasin sektorit të ujit. Si pjesë e angazhimit për transparencë dhe llogaridhënie në politikat e shpërndarjes së informacionit, ERRU ka përditësuar rregullisht faqen zyrtare me përmbajtje të re. Këtu përfshihen njoftimet në lidhje me vendimet e marra në ERRU, raporte të përditësuara së bashku me buletinet 3 mujore që mbulojnë të gjitha zhvillimet më të fundit të lajmeve dhe aktiviteteve të ERRU-së. Gjithashtu, ka përfshirë përdorimin e një sërë platformash digjitale si p.sh “Instagram”, “Facebook”, “Linkedin” për të shpërndarë informacion të përgjithshëm në lidhje me të drejtat e detyrimet, tarifrat e konsumatorëve, si dhe standardet e cilësisë së shërbimit.

7. Të nxisë shoqëritë UK për të krijuar standarde efikente në trajtimin e ankesave, si dhe të vijojë procesin e monitorimit për procedurat e trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve nga ana e shoqërive UK.

Krijimi dhe organizimi i shoqërive rajonale ujësjellës kanalizime ka paraqitur sfida të reja në drejtim të organizimit për trajtimin e ankesave të konsumatorëve. ERRU, përgjatë këtij viti është kujdesur duke përcjellë rekomandimet përkatëse që shoqëritë, nëpërmjet pikave të kujdesit ndaj klientit, të respektojnë afatet dhe procedurat e trajtimit të ankesave konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Mekanizmi i pranimit të ankesave nëpërmjet faqes zyrtare të ERRU-së www.erru.al ka sjellë lehtësi procedurale kryesisht për konsumatorët familjarë për të drejtuar një ankesë pranë ERRU-së pavarësisht zonës së banimit. Gjithashtu, nëpërmjet strukturës për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM), ERRU ka intensifikuar punën e monitorimit në terren të ankesave të konsumatorëve, kryesisht të ankesave me natyrë teknike që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e furnizimit me ujë të pijshëm. Trajtimi i këtyre ankesave ka rezultuar pozitiv dhe ata kanë marrë një zgjidhje të kënaqshme për konsumatorët.

8. Të hartojë një metodologji për një analizë sa më realiste dhe efikase të organigramës së shoqërive rajonale për të bërë të mundur reduktimin e abuzimeve dhe punësimin e stafit të tepërt nga ana e shoqërive rajonale.

Në vijim të reformës në sektorin UK e cila i ka fillimet e veta në maj të vitit 2022, nga ana e AKUK është hartuar një strukturë organizative e unifikuar për çdo shoqëri UK rajonale, e cila sigurisht që përshtatet më tej në numër stafi sipas nevojave dhe madhësisë që ka secila shoqëri UK rajonale. Në këtë kuadër, nga ana e ERRU-së gjatë vitit 2024 nuk është ndërmarrë një veprim konkret në hartimin e një

metodologjie specifike, për vetë faktin se po analizohet ecuria e shoqërive UK rajonale në këtë fazë tranzicioni pas reformës, në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë të situatës përpara se të ndërmerren veprime konkrete në këtë drejtim. Gjithsesi, ERRU ka vijuar t'i kushtojë një vëmendje të veçantë ecurisë së treguesit të efikasitetit të stafit, i cili për vitin 2024 zë 45% të kostove O&M në sektorin UK. Kjo sidomos për shoqëritë që kanë aplikuar për nivel të ri tarifor gjatë vitit 2024, ku në çdo vendimarrje ka vendosur objektiva sfidues dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse që duhen marrë në konsideratë nga shoqëritë UK me qëllim reduktimin e kostove të punës dhe rritjen e efikasitetit.

9. Në aplikimin që bëjnë shoqëritë rajonale për tarifa të reja, të ndjekë një politikë agresive për përmirësimin e Treguesve të Performancës nga ana e shoqërive UK, sidomos për reduktimin e humbjeve administrative dhe fizike, mbështetur në një analizë të detajuar tekniko – ekonomike që evidenton mundësitë reale që ka shoqëria për përmirësimin e këtyre treguesve.

Treguesit kryesorë të performancës janë një element shumë i rëndësishëm, të cilët analizohen me shumë kujdes nga ERRU, sidomos në momentin kur shoqëritë UK aplikojnë për nivel të ri tarifor. Përmes këtyre treguesve, ERRU monitoron efikasitetin e shoqërive UK gjatë operimit të tyre. Në këtë kontekst, në përgjithësi ERRU zbaton praktikën e vendosjes së objektivave agresive mbi TKP për të ardhmen dhe sidomos kur bëhet fjalë për reduktimin e humbjeve administrative dhe fizike. Këto objektiva janë pjesë e vendimit final të KKRR për miratimin e tarifave të reja, praktikë kjo e ndjekur edhe në rastin e vendimeve për tarifa të reja për 6 shoqëri UK rajonale gjatë vitit 2024 të paraqitura në tabelën nr.7 të mëposhtme.

Tabela Nr. 7, Treguesi i Ujit Pa të Ardhura

Nr.	Shoqëria	Treguesi i UPA, Viti bazë (në %)	Objektivi i Shoqërisë UPA, (në %)	Objektivi i vendosur nga ERRU UPA (në %)
1	UKR Lezhë	74.14	69.33	65
2	UKR Fier	69.59	56.45	56.45
3	UKR Durrës	75.52	69.61	69
4	UKR Pogradec	34.48	34.38	32
5	UKR Gjirokastrë	42.55	38	37
6	UKR Shkodër	67.02	59.31	59

*** Për UKR Lezhë objektivi i vendosur është deri në fund të vitit 2025, ndërsa për shoqëritë e tjera objektivi i vendosur është deri në fund të vitit 2027 referuar periudhës rregullatore të vendosur për secilën shoqëri.**

Siç shihet nga tabela e mësipërme, ERRU në disa raste është treguar dukshëm më agresive në vendosjen e objektivit të UPA si në rastin e shoqërive rajonale UKR Lezhë dhe UKR Pogradec, krahasuar me objektivat aktual dhe të parashikuar nga vetë shoqëria. Gjithashtu, e njëjta logjikë është ndjekur edhe për shoqëritë e tjera, përfshirë këtu edhe shoqërinë UKR Fier, megjithëse në pamje të parë duket se nuk ka ndryshim nga objektivi i parashikuar nga vetë shoqëria. Kjo është pranuar si e drejtë referuar një analizë të detajuar tekniko-ekonomike të realizuar nga ERRU, e cila ka nxjerrë në pah mundësitë reale që ka kjo shoqëri për përmirësimin e këtij treguesi, i cili parashikohet të ketë një përmirësim të konsiderueshëm me rreth 13% krahasuar me vitin bazë.

10. Të bashkëpunojë me AKUK për të bërë të mundur mbështetjen e duhur financiare dhe asistencë teknike për përballimin e vështirësive që kanë aktualisht shoqëritë rajonale për menaxhimin e aktiviteteve të tyre, si rakordimi dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura me institucionet financiare kombëtare dhe ndërkombëtare, rakordimi i numrit të klientëve debitorë në sistemin me ato në bilancet financiare nga UK-të ekzistuese.

Riorganizimi i sektorit UK, nga 58 shoqëri UK ekzistuese në 15 shoqëri UK rajonale (14 UK rajonale të krijuara deri në mbyllje të vitit 2024) nxori në pah një sërë problematikash të mbartura ndër vite nga shoqëritë UK ekzistuese, kryesisht ato të vogla, të cilat në disa raste nuk kishin kapacitetet e nevojshme të stafeve si dhe mundësitë e duhura financiare për të ngritur sistemet e nevojshme digjitale si software etj, për mbajtjen e informacioneve të shoqërisë. Informacionet mbaheshin në regjistra fizikë, përfshirë këtu edhe faturimin ndaj konsumatorëve, duke ndikuar kështu në saktësinë dhe operimin normal të shoqërive. Referuar konstatimeve të bëra nga ERRU, të cilat përpos shoqërive UK i janë bërë prezent edhe AKUK, ky i fundit i ka dhënë përparësi zgjidhjes së kësaj problematike duke vendosur fondet e nevojshme në dispozicion për pajisjen me software përkatës të çdo shoqërie UK rajonale. Si rezultat, tashmë i gjithë sistemi financiar dhe i faturimit të shoqërive UK është i digjitalizuar duke kontribuar drejtpërdrejt në operimin normal të tyre. Ngritja e sistemeve të informacionit krijon gjithashtu kushtet për mbledhjen dhe raportim të dhënave të besueshme nga shoqëritë UK, i cili i mundëson rregullatorit dhe stafeve menaxhuese të shoqërive një vlerësim real të TKP-ve, si dhe vendosjen e objektivave racionale, duke lehtësuar kështu procesin e monitorimit të shoqërive UK në veçanti dhe sektorit UK në tërësi.

11. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me AKUK “Për Hartimin dhe Miratimin e Modelit të Planit 5-vjeçar të Biznesit për Shërbimet UK”, të mbikëqyrë përgatitjen dhe miratimin e modelit të unifikuar të planeve 5- vjeçare, si dhe udhëzuesin përkatës, në përputhje me termat e referencës dhe kushtet e parashikuara në kontratën me konsulentin.

Në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit me AKUK, gjatë vitit 2024 ka filluar puna intensive mbi hartimin dhe miratimin e Modelit të Planit 5-vjeçar të Biznesit, i cili është asistuar me konsulencë të huaj(kompania SEURECA) të mbështetur nga Banka Botërore. ERRU ka luajtur rolin kryesor në drejtimin e punës, duke bashkëpunuar ngushtësisht me konsulentin në drejtim të udhëzimeve dhe nevojave që duhet të përfshihen në planin e biznesit si një dokument shumë i rëndësishëm për shoqëritë UK dhe që duhet të ketë patjetër në konsideratë edhe metodologjinë aktuale të tarifave të përdorur nga ERRU. Deri në mbyllje të vitit 2024 është arritur të përmbyllet drafti final i këtij dokumenti, i cili është miratuar parimisht nga ERRU. Ky dokument do të përcillet për komente tek aktorët kryesorë të sektorit UK për të vijuar më tej me miratimin final të tij. Vlen të theksohet se ky dokument do të jetë një udhëzues shumë i mirë i hartimit të planit 5-vjeçar të biznesit për shoqëritë UK, sidomos për ato shoqëri të cilat bulojnë mbi 100% kostot O&M dhe tentojnë të mbulojnë kostot totale. Këto të fundit e kanë detyrim aplikimin për nivel të ri tarifor sipas planit 5-vjeçar të biznesit. Pas miratimit të këtij dokumenti nga ERRU, çdo shoqëri e cila e ka kusht hartimin e planit 5-vjeçar të biznesit, në momentin e aplikimit për nivel të ri tarifor është e detyruar të paraqitet me një plan të strukturuar sipas këtij dokumenti të miratuar nga ERRU.

12. Në kuadër të hapjes së negociatave me BE-në të kontribuojë në përmbushje të kërkesave të *acquis* në lidhje me direktivat evropiane për ujin e pijshëm, ujërat e ndotura dhe të llumrave të ITUN.

ERRU, edhe gjatë këtij viti ka vijuar kontributin e tij në drejtim të përmbushjes së kërkesave në lidhje me direktivat evropiane duke bashkëpunuar me AKUK, si pjesë e grupeve të punës së projektit “Planifikimi i sektorit të ujit, për negociatat me BE”, i cili filloi në nëntor të vitit 2021, në kuadër të marrëveshjes së grantit, të firmosur ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj suedeze, specifikisht në përgatitjen e Planeve Specifike të Zbatimit të Direktivave (DSIP) së Ujit të Pijshëm (DWD), Ujërave të Ndotura (UWWTD) dhe Raporti i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Llumrave (NSMS). Në dhjetor të vitit 2024, u zhvillua takimi i fundit përmbyllës, për sa i përket planit të zbatimit të Direktivës për Ujin e Pijshëm 2020/2184 për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor (reformuar), ku u diskutuan të gjitha korrigjimet dhe komentet finale të sugjeruara nga ekspertët ndërkombëtarë dhe grupi i punës.

13. Duke pasur parasysh ndikimin që ka kostoja e energjisë në kostot operacionale të shoqërive UK, të kërkojë nga shoqëritë rajonale UK të bëjnë një studim për efencën e energjisë në sistemet e furnizimit me ujë duke u fokusuar në përdorimin e burimeve alternative të rinovueshme nga shoqëritë UK.

Kostot e energjisë edhe për vitin 2024 vijnë të mbeten zëri i dytë i kostove O&M pas atyre të punës në sektorin UK. ERRU, në mënyrë të vazhdueshme i ka kushtuar vëmendje të veçantë këtij zëri të kostos duke e analizuar në detaje, sidomos në momentin kur shoqëritë UK aplikojnë për nivel të ri tarifar. Në këtë kontekst, ERRU jep edhe rekomandimet përkatëse për secilën shoqëri UK individuale mbi masat e nevojshme që duhen ndërmarrë prej tyre për përmirësimin e efencës së energjisë duke konsideruar edhe burimet alternative të saj. Në të njëjtën kohë, rekomandime të tilla janë dhënë në mënyrë të vazhdueshme nga ERRU edhe në drejtim të AKUK si institucioni përgjegjës i përcaktimit të investimeve në sektorin UK.

Me riorganizimin e sektorit UK në maj të vitit 2022, sipas VKM nr. 302, roli i AKUK është forcuar më tej pasi është dhe aksionari kryesor i shoqërive UK me 51 % të aksioneve. Në vijim të reformës, AKUK, me mbështetjen e Bankës Botërore ka filluar të zbatojë Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, ku janë planifikuar të zbatohen projekte për efencën e energjisë dhe energjinë e rinovueshme në shoqëritë UK. Ndërhyrjet e efencës së energjisë, të prioritizuara në udhëzimet e politikave për investimet kapitale, pritet të japin kursime të efencës së energjisë deri në 25%. Programi parashikon auditime të detajuara të Eficencës së Energjisë që do të ndërmerren në sistemet prioritare të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për të identifikuar potencialin për kursimin e kostove të energjisë dhe për të përshkruar investimet e nevojshme për ndërmarrjet UK të cilat duhen financuar. Në kuadër të këtij programi, në fazën e parë janë përcaktuar auditimet e përgjithshme të energjisë në pesë shoqëri UK rajonale si: UKR Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan, dhe Shkodër, të cilat përfaqësojnë 40 % të ngarkesës të lidhur me konsumin vjetor.

Ky auditim do të kryejë identifikimin e plotë të situatës aktuale të konsumit të energjisë të pajisjeve, makinerive të ndryshme, motorëve dhe linjave, duke paraqitur mundësitë e ndërhyrjeve dhe përmirësimeve të ndryshme për uljen e konsumit të energjisë, ndikimin në mjedis dhe uljen e

emetimeve të gazeve serrë si dhe duke vlerësuar potencialin për energjinë e rinovueshme përmes sistemeve fotovoltaike.

3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi

Një pjesë shumë të rëndësishme në Raportin Vjetor të aktivitetit të ERRU zë edhe pjesa e rekomandimeve të nevojshme për t'u ndërmarrë nga qeveria qendrore për përmirësimin e performancës së sektorit të ujit. Rekomandimet vijnë si rezultat i njohjes së thellë që ERRU ka për sektorin UK nga një eksperiencë tashmë 27 vjeçare në rregullimin e sektorit të ujit në Shqipëri. Në raportin vjetor të aktivitetit të ERRU-së për vitin e mëparshëm (2023) dërguar pranë Këshillit të Ministrave dhe të prezantuar në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë si dhe në Raportin e Performancës për shoqëritë UK të vitit 2023, janë dhënë disa rekomandime, të cilat ERRU i vlerëson si të arsyeshme për t'u marrë në konsideratë nga qeveria qendrore, si më poshtë:

- ***Të bëhen përpjekjet maksimale nga ana e AKUK me mbështetjen e duhur financiare dhe asistencë teknike për përballimin e vështirësive që kanë aktualisht shoqëritë rajonale për menaxhimin e aktiviteteve të tyre të përqendruara kryesisht në gjetjet nga auditimi i pavarur, si rakordimi dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura me institucionet financiare***

Referuar konstatimeve të bëra nga ERRU, të cilat i janë bërë prezent edhe AKUK, ky i fundit i ka dhënë përparësi zgjidhjes së kësaj problematike duke vendosur fondet e nevojshme në dispozicion për pajisjen me softuer përkatës të çdo shoqërie UK Rajonale. Riorganizimi i sektorit UK nxori në pah një sërë problematikash të mbartura ndër vite nga shoqëritë UK ekzistuese, kryesisht ato të vogla, të cilat në disa raste nuk kishin kapacitetet e nevojshme të stafeve si dhe mundësitë e duhura financiare për të ngritur sistemet e nevojshme digjitale si softwer etj, për mbajtjen e informacioneve të shoqërisë. Si rezultat, i gjithë sistemi financiarë dhe ai i faturimit të shoqërive UK është i digjitalizuar duke kontribuar drejtpërdrejt në operimin normal të tyre. Ngritja e sistemeve të informacionit krijon gjithashtu kushtet për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të besueshme nga shoqëritë UK, i cili i mundëson rregullatorit dhe stafeve menaxhuese të shoqërive një vlerësim real të TKP-ve, si dhe vendosjen e objektivave racionalë duke lehtësuar kështu procesin e monitorimit të shoqërive UK në veçanti dhe sektorit UK në tërësi.

- ***Në përgjigje të krizës globale energjetike dhe të ndikimit të saj eventual në vendin tonë, të shihet si prioritet hartimi i Planeve të Rritjes së Eficencës së Energjisë për shoqëritë UK dhe fillimi i zbatimit të tyre, përfshirë fondet përkatëse të nevojshme për këtë qëllim, si faktor që ndikon drejtpërdrejt në uljen e kostove të O&M***

Në vijim të reformës, AKUK, me mbështetjen e Bankës Botërore ka filluar të zbatojë Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, ku janë planifikuar të zbatohen projekte për eficientësi të energjisë dhe energjinë e rinovueshme në shoqëritë UK. Në kuadër të këtij programi, në fazën e parë janë përcaktuar auditimet e përgjithshme të energjisë

në pesë shoqëri UK rajonale si: UKR Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan, dhe Shkodër të cilat përfaqësojnë 40 për qind të ngarkesës të lidhur me konsumin vjetor.

Programi parashikon auditime të detajuara të Eficencës së Energjisë që do të ndërmerren në sistemet prioritare të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për të identifikuar potencialin për kursimin e kostove të energjisë dhe për të përshkruar investimet e nevojshme për ndërmarrjet UK të cilat duhen financuar. Si rezultat, ky auditim do të kryejë identifikimin e plotë të situatës aktuale të konsumit të energjisë të pajisjeve, makinerive të ndryshme, motorëve dhe linjave, duke krijuar mundësinë e hartimit të një plani veprimi për uljen e konsumit të energjisë si dhe duke vlerësuar potencialin për energjinë e rinovueshme përmes sistemeve fotovoltaike.

- ***Të planifikohen dhe alokohen fondet përkatëse nga AKUK për pajisjen e të gjithë sistemeve të FU, me ujëmatës të mëdhenj në burim, në mënyrë që shoqëritë UK të kenë mundësinë e hartimit të saktë të balanceve të ujit, vlerësimit të humbjeve si dhe gjendjen reale të kërkesës për ujë.***

Pajisja me ujëmatës individuale me qëllim arritjen e objektivit 100% të mbulimit të klientëve me ujëmatës ka patur përmirësim të vazhdueshëm nga viti në vit, si rezultat i investimeve të kryera në këtë drejtim. Kjo është konstatuar edhe gjatë vitit 2024, ku niveli i matjes në rang sektori paraqitet në 87.9% i përmirësuar me rreth 1.4% krahasuar me vitin 2023. Gjithashtu, ecuria pozitive e këtij treguesi është vërejtur edhe gjatë aplikimeve të shoqërive UK Rajonale për nivel të ri tarifar, ku objektivat e parashikuara nga vetë shoqëritë dhe ato të vendosura nga ERRU, kanë qenë sfiduese. Kjo ecuri pozitive nuk është reflektuar akoma në drejtim të investimeve për vendosjen e ujëmatësve të mëdhenj në prodhim për të gjithë shoqëritë UK rajonale. Deri më tani, akoma nuk është planifikuar ndonjë fond i veçantë nga AKUK vetëm për këtë zë. Si rrjedhojë, realizimi i këtij rekomandimi mbetet për t'u konsideruar në vitin në vazhdim si një investim i domosdoshëm, i cili ndikon në përcaktimin real të kërkesës për ujë dhe në hartimin e saktë të balanceve të ujit.

- ***Duke patur parasysh që një pjesë të mirë të kostove të justifikuara që duhet të mbulohen me tarifa e përbëjnë investimet e reja, duhet të krijohet mundësia që ERRU të përfaqësohet për të dhënë rekomandimet e saj në komisionet teknike pranë AKUK për aprovimin e projekteve të reja për investime.***

ERRU, ka bërë sugjerimet e nevojshme në draft ligjin e ri për sektorin UK, i cili nuk është miratuar akoma në mënyrë që ERRU të mund të kontribuojë për një shpërndarje të drejtë të investimeve për shoqëritë.

- ***Në vijim të reformës në sektorin UK, të hartohen nga shoqëritë rajonale Planet e Menaxhimit të Aseteve, përfshirë dhe ndërtimin e një sistemi të unifikuar digjital të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së asetëve.***

Planet e Menaxhimit të Aseteve duhet të jenë në fokusin e AKUK si një domosdoshmëri për një planifikim sa më të drejtë dhe efikas të investimeve. Si rezultat i reformës në sektorin UK, tashmë kemi të bëjmë me shoqëri UK rajonale, të cilat kanë kapacitetet e nevojshme financiare dhe të stafeve, i cili përpos pjesës financiare është një element kyç në menaxhimin e asetëve. Në këtë

kuadër, AKUK duhet të marrë sa më parë iniciativën për të mbështetur me investime ngritjen e një sistemi digjital të unifikuar të menaxhimit të aseteve për çdo shoqëri UK rajonale në sektor. Kjo sigurisht që do të ishte një hap shumë i rëndësishëm për shoqëritë UK rajonale duke i bërë ato më të qëndrueshme dhe eficientë në operimin e tyre. Realizimi i këtij rekomandimi mbetet për t'u konsideruar në vitin në vazhdim nga AKUK si një domosdoshmëri për sektorin UK.

4 Ecuria e Reformës në Sektorin UK sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022

Reforma në sektorin UK, e cila i ka fillimet e saj në maj të vitit 2022 sipas VKM nr.302 synon agregimin e sektorit UK në 15 shoqëri UK rajonale, nga një sektor i fragmentarizuar në 58 shoqëri UK në 61 bashki të vendit. Objektivi kryesor i reformës ishte që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK.

Gjatë vitit 2024 procesi i rajonalizimit ka hyrë në një fazë të plotë operimi me formimin e 14 shoqërive UK rajonale të krijuara nga totali prej 15 të tilla të parashikuara në reformë, konkretisht shoqëritë UK Rajonale *Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Fier, Lushnjë, Sarandë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Berat, Gjirokastrë dhe Vlorë*.

Procesi i riorganizimit ka vijuar të ndiqet me shumë intensitet nga ERRU, i cili ka luajtur një rol pro aktiv gjatë këtij procesi duke licencuar në kohë shoqëritë UK rajonale të krijuara sipas reformës. Deri në mbyllje të vitit 2024, nga ERRU janë licencuar 14 shoqëri UK rajonale, nga 14 të krijuara.

Mbetet akoma pa u krijuar Shoqëria Rajonale UK *Tiranë*, e cila përfshin bashkitë: Tiranë, Kamzë dhe Vorë. Vonesat në krijimin e Shoqërisë UK Rajonale Tiranë sipas parashikimeve të VKM nr.302, vijnë si rezultat i diskutimeve në vazhdim për pika të veçanta të karakterit teknik ndërmjet drejtuesve të pushteteve vendore dhe MIE.

Gjithashtu, ERRU ka luajtur një rol pro aktiv edhe gjatë procesit të aplikimit të shoqërive UK rajonale për nivel të ri tarifor duke dhënë asistencën e nevojshme në këtë drejtim pasi rajonalizimi i sektorit UK përkoi pothuajse në të njëjtën kohë edhe me metodologjinë e re të tarifave të miratuar nga ERRU sipas Vendimit të KKRR Nr. 539, datë 30.12. 2021. Në këtë kuadër, të gjitha shoqëritë UK rajonale të cilat kanë aplikuar për nivel të ri tarifor që nga momenti i fillimit të reformës (9 shoqëri UK Rajonale) kishin nevojë për asistencë teknike nga ERRU në përmbushje të kërkesave të parashikuara në metodologjinë e tarifave.

Një tjetër element sfidues për shoqëritë UK rajonale është edhe synimi për të unifikuar tarifat në të gjithë zonën e re të shërbimit. Referuar situatës aktuale të tarifave të këtyre shoqërive para reformës rezulton se në disa raste është e pamundur të realizohet unifikimi i tarifave në këtë fazë fillestare, por në disa nga shoqëritë rajonale tarifat janë të përafërta nga zona në zonë duke krijuar kështu mundësitë për unifikim tarifor në të gjithë zonën e shërbimit.

ERRU inkurajon procesin e unifikimit tarifar për nivel të njëjtë shërbimesh UK, sepse duke patur të dhënat e variablave tekniko-financiare të përbashkëta krijohet mundësia e një menaxhimi financiar dhe monitorimi relativisht më të kontrollueshëm dhe efikas. Në të njëjtën kohë, zbatohet edhe parimi i barazisë ndaj detyrimit financiar ndërmjet klientëve në zonën e shërbimit.

Gjithsesi, unifikimi tarifar duhet parë me kujdes rast pas rasti, pasi praktika ka treguar se nga rritja e menjëhershme e në mënyrë të konsiderueshme e tarifave, shoqëria ndeshet me një rezistencë nga ana e konsumatorëve për të mos paguar faturat e shërbimeve. Pra, si rezultat ullet norma e arkëtimit dhe aftësia likuiduese e shoqërisë, si dhe e treguesve financiarë në përgjithësi.

Në këtë rast, duke qenë se metodologjia ofron mundësinë e planifikimit tarifar me rritje graduale, unifikimi i tyre mendohet të realizohet me faza sipas specifikave të çdo rasti, si dhe duhet shoqëruar me rritje të cilësisë së shërbimit në këto zona. Në këtë mënyrë krijohen kushtet për një nivel të ri tarifar të unifikuar, i cili sjell të ardhura të faturuara më të larta, rrjedhimisht edhe një performancë financiare të përmirësuar dhe të qëndrueshme të shoqërisë UK rajonale.

ERRU, edhe gjatë vitit 2024 ka vijuar me takime të drejtpërdrejta me drejtuesit e AKUK, drejtuesit e shoqërive UK rajonale dhe kryetarët e këshillave mbikëqyrëse, ku janë diskutuar një sërë problematikash me të cilat po përballen shoqëritë e reja UK rajonale.

Riorganizimi i sektorit UK është një proces kompleks i cili ka shfaqur shumë sfida dhe të panjohura në terren gjatë implementimit të tij për realizimin me sukses të reformës. Në këtë kontekst, shoqëritë e reja të krijuara u përballën me një sërë problematikash në drejtim të menaxhimit, operimit, të situatës financiare të shoqërive UK ekzistuese, të cilat u vunë re gjatë auditimit të tyre nga ekspertët e pavarur dhe drejtuesit e shoqërive UK rajonale.

Agregimi i sektorit është një proces që kërkon vëmendje të vazhdueshme nga qeveria qendrore në drejtim të menaxhimit të aseteve ekzistuese dhe planifikimit sa më të drejtë të subvencioneve dhe investimeve të nevojshme që duhen kryer për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve si synimi final i këtij procesi.

5 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2025

- Të përfundojë procesin e miratimit të tarifave për të gjitha shoqëritë rajonale UK të krijuara në kuadër të riorganizimit të sektorit, si dhe të ofrojë asistencën rregullatore në zbatimin efektiv të metodologjisë për vendosjen e tarifave nga ana e shoqërive.
- Të përfundojë procesin e krijimit të një sistemi të unifikuar kombëtar raportimi të dhënash në kohë reale dhe të detajuar lidhur me shërbimet UK, me synim rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave dhe vlerësimit sa më real të gjendjes së sektorit.
- Të miratojë modelin e Plan Biznesit për shoqëritë UK dhe udhëzuesin përkatës, i detyrueshëm për t'u respektuar nga të gjithë shoqëritë në momentin e aplikimit për nivel të ri tarifar pranë ERRU, në vijim të marrëveshjes së nënshkruar me AKUK.
- Të intensifikojë punën nëpërmjet kanaleve të komunikimit për ndërgjegjësimin e konsumatorit për rolin ndërveprues që ka në marrëdhënie me ofruesit e shërbimit dhe sensibilizimin për mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet dedikuar shërbimeve UK.
- Të luajë një rol kryesor dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët që operojnë në sektorin e ujit për të bërë të mundur realizimin e objektivave strategjikë sektorialë, si dhe për krijimin e një mjedisi që siguron stabilitet për shoqëritë UK dhe shërbim më të mirë për konsumatorët.
- Të vijojë trajtimin e ankesave të konsumatorëve nëpërmjet mjeteve të ankimimit dhe strukturës së ngritur posaçërisht për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve.
- Të vijojë bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare dhe rregullatorët evropiane për të ndarë njohuritë dhe përvojat si dhe të mbajë një qasje ndërvepruese në identifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e praktikave më të mira rregullatore.
- Të kontribuojë në mënyrë aktive mbi aspektet rregullatore në të gjitha Grupet e Punës ndërinstitutionale që lidhen me politika strategjike apo tematika specifike të sektorit UK apo ato të mbrojtjes së konsumatorit.
- Të forcojë kapacitetet profesionale të stafit përmes një planifikimi të mirëfilltë të trajnimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe mundësitë që ofrohen nga bashkëpunimet bilaterale me rregullatorët evropianë të sektorit të ujit.
- Në përgjigje të statusit të hapjes së negociatave me BE, të kontribuojë në përmbushje të kërkesave të “acquis communautaire” të Shqipërisë, në lidhje me Direktivat Evropiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe të Llumrave të ITUN.

6 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2024

Pjesë e Raportit Vjetor të aktivitetit të ERRU-së është edhe ecuria e Performancës së Sektorit UK për vitin 2024, e cila analizohet sipas Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP) të miratuar nga KKRR. Raporti është strukturuar sipas shoqërive të riorganizuara sipas VKM nr. 302, në vijim të së cilës kanë zhvilluar aktivitetin e tyre dhe kanë raportuar si shoqëri rajonale 14 nga 15 që parashikon reforma. Për shoqëritë e tjera të pa rajonalizuara, përkatësisht: UK Tiranë, Kamzë dhe Vorë të dhënat e raportuara dhe vlerësimi i tyre janë bërë të veçanta.

Të dhënat e raportuara nga shoqëritë UK në këtë raport konsiderohen paraprake, por të përafërta me ato që do të jenë në mbyllje të bilanceve financiare në fund të muajit mars 2024 dhe të certifikuara nga një ekspert kontabël i autorizuar.

Gjithsesi, një analizë e plotë dhe më e detajuar e performancës së sektorit të ujit në përgjithësi dhe e çdo shoqërie UK në veçanti për vitin 2024, do të jepet në Raportin Vjetor të Performancës së sektorit UK që hartohet dhe botohet çdo vit nga ERRU në fund të muajit qershor me të dhëna të plota vjetore të certifikuara nga ekspertët kontabël ligjorë.

Në tabelën nr. 8, jepen vlerat e TKP-ve për vitin 2024 dhe tendenca e tyre krahasuar me vitin paraardhës 2023.

Tabela Nr.8. Treguesit Kryesorë të Performancës për Vitet 2023-2024

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2023	Viti 2024	Tendenca
1	Uji Pa të Ardhura	%	64.7	61.1	↗
2	Mbulimi i Kostove O&M	%	100.5	109.8	↗
3	Norma e Arkëtimit Korrente	%	83.9	83.2	↘
4	Norma e Arkëtimit të Përgjithshme	%	103.5	102.4	↘
5	Niveli i Matjes	%	86.5	87.9	↗
6	Efienca e Stafit	(staf/1000 lidhje UK)	4.56	4.51	↗
7	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	16.3	17.3	↗
8	Mbulimi i Furnizimit me Ujë	%	75.3	77.2	↗
9	Mbulimi me Kanalizime	%	54.8	56.2	↗
10	Efienca e Energjisë FU	kWh/m ³	0.63	0.58	↗-
11	Ankesat e Klientëve	%	4.23	3.6	↗

Burimi: ERRU

Referuar tabelës së mësipërme, vërehet se performanca e sektorit UK sipas Treguesve Kryesorë të Performancës paraqitet e përmirësuar pothuajse në të gjithë treguesit e saj me përjashtim të treguesve të “Normës së Arkëtimit Korrente” dhe “Normës së Arkëtimit të Përgjithshme”, të cilët paraqiten me një rënie të lehtë krahasuar me vitin paraardhës 2023. Gjithsesi, vlera e këtyre treguesve duhet marrë me rezervë në këtë moment, pasi raportimet nga ana e shoqërive UK janë paraprake para mbylljes së bilanceve financiare të certifikuara. Vlen të theksohet se kjo nuk ka influencuar në performancën financiare të sektorit, ku mbulimi i kostove O&M për vitin 2024 paraqitet në nivelin e 109.8% i përmirësuar me 9.3%.

*Gjithashtu pjesa tjetër e treguesve të performancës, si **Niveli i Matjes, Eficienca e Stafit, Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, Mbulimi me Kanalizime dhe Eficienca e Energjisë**, të cilët paraqiten të përmirësuar kanë pasur ndikimin e tyre në përmirësimin e situatës financiare të shoqërive dhe në cilësinë e ofrimit të shërbimit ndaj konsumatorëve.*

Referuar të dhënave të mësipërme konstatohet se reforma në sektorin UK, në mbyllje të vitit të dytë të implementimit të saj, ka dhënë impakt pozitiv në drejtim të përmirësimit në përgjithësi të situatës financiare të sektorit dhe rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar krahasuar me vitin paraardhës 2023, të cilët kanë qenë dhe objektivat kryesorë të reformës.

Më poshtë jepet në mënyrë të përmblodhur analiza e ecurisë për secilin TKP:

"Uji Pa të Ardhura", i cili është një nga treguesit më të rëndësishëm që ndikon në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK, për vitin 2024 paraqitet i përmirësuar ndjeshëm me rreth 3.6% krahasuar me një vit më parë, përkatësisht në nivelin 61.1% nga 64.7%.

Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rritjes së volumit të ujit të faturuar me rreth 5.7 milionë m³ dhe uljes së atij të prodhuar me rreth 16.5 milionë m³, nga të cilat rreth 13 milionë m³ me ngritje mekanike. Pothuajse të gjitha shoqëritë UK kanë performuar mirë në këtë drejtim. Në veçanti përmenden shoqëritë rajonale UK Kamzë me 5.2 milionë m³, UKR Lezhë me 4.04 milionë m³, UKR Durrës me 3.4 milionë m³, UKR Elbasan me 3.2 milionë m³ dhe UKR Sarandë me 2.2 milionë m³ ujë të prodhuar më pak gjatë vitit 2024, por pa influencuar në kohëzgjatjen e furnizimit me ujë, e cila në rang sektori është rritur me 1 orë/ditë.

*Gjithsesi, edhe pse i përmirësuar, treguesi i **Ujit Pa të Ardhura** vijon të mbetet përsëri në nivele mjaft të larta mbi 60%. Objektivi kryesor për shoqëritë UK për përmirësimin e këtij treguesi duhet të shoqërohet me investimet përkatëse për instalimin e matësve në burim, për një përcaktim më të saktë të sasisë së ujit të prodhuar, plotësimi 100% i klientëve me matës individualë, si dhe me zbatimin e vazhdueshëm të detyrave nga task forcat përkatëse për zbulimin e lidhjeve të paligjshme dhe rritjen e faturimit në përgjithësi.*

"Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes" është një tregues i performancës financiare i cili paraqet nivelin e menaxhimit të kostove dhe të ardhurave nga shoqëritë UK. Në të përfshihen vetëm kostot që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen dhe përjashtohen kostot e amortizimit, huave dhe kostot financiare. Për vitin 2024, mbulimi i kostove O&M për sektorin UK është në nivelin e 109.8%, nga 100.5% në vitin paraardhës 2023.

Gjatë vitit 2024, në sektor kanë zhvilluar aktivitetin e tyre 14 shoqëri UK Rajonale dhe 3 shoqëri UK të pa rajonalizuara. Referuar raportimeve përkatëse rezulton se në sektor janë 8 shoqëri UK me performancë të mirë financiare duke mbuluar mbi 100% kostot O&M, nga të cilat 7 shoqëri rajonale: **UKR Korçë, Berat, Gjirokastrë, Lezhë, Pogradec, Sarandë, Kukës si dhe UK Tiranë** si shoqëri UK individuale.

Vërehet se nga shoqëritë e tjera, 9 shoqëri i mbulojnë kostot nga 75% deri 100% ku 2 shoqëri UK Vorë dhe UK Kamzë janë shoqëri ekzistuese. Mbulimi i Kostove Totale, për vitin 2024, arrihet vetëm nga shoqëria UK Tiranë.

“Mbulimi i Kostove Totale”, pra ku përfshihen dhe kostot e amortizimit, huave dhe kostot financiare, për vitin 2024, realizohet vetëm nga shoqëria UK Tiranë në nivelin e 109.7%.

Tabela 9 jep në detaje kostot për sektorin e Ujësjellës Kanalizime për dy vitet ku përfshihen kostot përbërëse të O&M dhe ato Totale.

Tabela Nr.9 Kostot e O&M, Kostot Totale dhe të Ardhurat për vitet 2023 dhe 2024

Nr.	Emërtimi	Viti 2023	Viti 2024	Diferenca
	Kostot e Shërbimit UK	në 000 lekë	në 000 lekë	në 000 lekë
1	Kosto e punës	5,540,678	5,673,481	132,803
2	Kosto e energjisë së konsumuar	2,437,001	2,419,379	(17,622)
3	Kosto e riparim/mirëmbajtjes	428,846	541,037	112,191
4	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	604,248	505,753	(98,495)
5	Kosto e materialeve kimikate	267,527	211,963	(55,564)
6	Kosto të tjera	1,067,917	1,091,187	23,270
	Kostot Operim & Mirëmbajtjes	10,346,217	10,442,800	96,583
7	Kostot e Amortizimit	2,658,990	2,723,921	64,931
8	Kosto financiare, taksa tatime	1,267,225	886,833	(380,392)
	Kostot Kapitale	3,926,215	3,610,754	(315,461)
	Kostot Totale	14,272,432	14,053,554	(218,878)
	Të Ardhurat:			
1	Nga shërbimet UK	10,112,554	11,176,235	1,063,681
2	Të ardhura të tjera lidhje, rilidhje etj.	282,644	291,080	8,436
	Të Ardhurat Totale	10,395,198	11,467,315	1,072,117
	Niveli i Mbulimit të Kostove			
	Mbulimi i Kostove të O&M	100.5%	109.8%	9.3%
	Mbulimi i Kostove Totale	72.8%	81.6%	8.8%

Sipas të dhënave, konstatohet se për vitin 2024, shoqëritë UK kanë zhvilluar aktivitetin e tyre me kosto operative pothuajse njësoj, të cilat janë rreth 1% më të larta se në vitin 2023 (+96.5 milionë lekë), ndërkohë edhe të ardhurat në sektor janë rritur me 10%, krahasuar me vitin paraardhës (+1.072 miliardë lekë). Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e performancës financiare në drejtim të mbulimit të kostove.

Referuar uljes në total të kostove, vihet re se kostot e shërbimeve të kontraktuara përbëjnë zërin kryesor me 16% të tij ose me rreth 98.5 milionë lekë më pak se në vitin 2023. Gjithashtu në trendin rënës të koston totale kanë ndikuar dhe kostot e materialeve dhe kostot e energjisë me rreth 55.5 milionë lekë dhe 17.6 milionë lekë. Përfundimisht Kosto e Punës që është rritur me 2% ose me rreth 132.8 milionë lekë e shkaktuar nga rritja e pagës minimale gjatë vitit 2024. Duhet theksuar se për këtë vit janë rritur me 26% ose me rreth 112.2 milionë lekë kostot e riparim/mirëmbajtjes krahasuar me 2023.

Kostot e Punës janë rritur për shkak se nga riorganizimi i sektorit numri i punonjësve është rritur më tej dhe kryesisht ai i stafit administrativ me 39 punonjës. Gjithashtu, dhe rritja e pagës minimale ka ndikuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” nga 34,000 lekë në 40,000 lekë në muaj, e cila ka hyrë në fuqi në datën 1 prill 2023.

Kostot e Energjisë janë ulur shumë pak krahasuar me vitin 2023, rreth 1% (me -17.6 milionë lekë). Kjo rënie e lehtë ka ardhur edhe për shkak të rënies së konsumit të energjisë me rreth (-17.7 milionë kWh) krahasuar me vitin 2023, ndërsa çmimi për njësi i energjisë elektrike nga ERE për vitin 2024 për shoqëritë UK të lidhura në nivelin e tensionit 35 KV dhe 20/10/6 KV, janë të pandryshuara si në vitin 2023, gjë e cila nuk ka ndikuar në koston e energjisë.

Ndikimin kryesor në uljen e konsumit të energjisë e kanë dhënë **UK Tiranë** (-4.6 milionë kWh), **UK Rajonale Elbasan** (-3.7 milionë kWh), **UK Vorë** (-2.6 milionë kWh) si dhe **UK Rajonale Durrës** me rreth (-2.4 milionë kWh).

Kostot e Riparimeve për vitin 2023 rezultojnë të jenë rritur me (+112.2 milionë lekë) për shkak të çmimeve të materialeve dhe shërbimeve të cilat janë rritur ndjeshëm gjatë këtij viti. Kjo pasi numri i defekteve të raportuara në rrjetin shpërndarës ka rritje të dukshme krahasuar me vitin 2023 me (+6853) defekte.

Kostot e Shërbimeve të Kontraktuara janë në rënie me 16% (-98.5 milionë lekë) ku ndikimin kryesor e kanë dhënë kryesisht shoqëritë **UK Tiranë, UK Rajonale Elbasan, Lushnje, Berat, Sarandë** dhe **UK Kamzë**. Në këto kosto peshën më të madhe e zënë shërbimet e kontraktuara për rojet private. Shoqëritë UK që investojnë në monitorimin e objekteve nëpërmjet sistemeve të sigurimit me kamera operojnë me kosto të reduktuar lidhur me kostot e shërbimeve për roje, eksperiencë e cila duhet të shtrihet në të gjitha shoqëritë në sektor shoqëruar me planifikimin dha implementimin e fondeve përkatëse për këtë qëllim.

Kosto të tjera Operacionale ku përfshihen kostot e qirave për zyrat, detyrimet ndaj institucioneve si ERRU, SHUKALB, Agjencive të Baseneve Ujore etj. Ky zë shpenzimesh raportohet me rritje prej +23.3 milionë lekë krahasuar me vitin 2023 për shkak të rritjes së çmimeve në vitin 2024.

Kostot Kapitale përfshijnë kostot e amortizimit, të cilat kanë rritje me +64.9 milionë lekë ku ndikimin kryesorë e ka dhënë **UK Rajonale Berat**, ndërsa kostot financiare taksa tatime rezultojnë të ulura me 30% (rreth -380.4 milionë lekë). Ulja në total prej 315.5 milionë lekë e këtyre kostove ka ndikuar në përmirësimin e treguesit të mbulimit të Kostove Totale me 8.8% krahasuar me vitin 2023.

Të Ardhurat nga Aktiviteti i UK për vitin 2024 janë rritur me 10% (+1,071miliard lekë), e cila ka ardhur kryesisht nga influenca e rritjes së numrit të lidhjeve të reja me +29,233, që kanë ndikuar në rritjen e nivelit të faturimit (me +1.063 milionë lekë). Volumi i ujit të faturuar për sektorin UK, është rritur me 5.7 milionë m³ edhe për shkak se disa shoqëri kanë përmirësuar treguesin e Vazhdimësisë së Furnizimit me Ujë, në krahasim me vitin 2023.

Gjithsesi, raportimet e vlerave të mësipërme duhet të konsiderohen paraprake sepse një analizë e detajuar e treguesve të Mbulimit të Kostove O&M dhe të Kostove Totale për vitin 2024, do të jepet në Raportin e Performancës së Sektorit UK, i cili publikohet në fund të muajit qershor 2025. Në këtë raport realizohet verifikimi dhe rakordimi i të dhënave duke iu referuar Bilanceve Kontabël të certifikuara nga një ekspert kontabël i autorizuar.

"Norma e Arkëtimit" është një nga treguesit më të rëndësishëm të performancës financiare të shoqërive, e cila lidhet drejtpërdrejt me qëndrueshmërinë financiare dhe me aftësinë paguese të tyre. Aktualisht monitorohen dy tregues: Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (NAP) dhe Norma e Arkëtimit

Korrente (NAK). NAP, në përlogaritjen e saj përfshin të gjitha arkëtimet e kryera nga shoqëria, përfshirë edhe debitë e vjetra, ndërsa NAK i përjashton këto të fundit.

Norma e Arkëtitimit Korrente për sektorin UK në vitin 2024 rezulton të jetë përkeqësuar me 0.7% dhe paraqitet në nivelin 83.2%, nga 83.9% që ishte në vitin 2023. Ndër shoqëritë që kanë ndikuar në përkeqësimin e këtij treguesi mund të përmendim shoqëritë: **UK Vorë, UKR Dibër, UKR Pogradec, UK Berat si dhe UK Tiranë. Kjo e fundit megjithëse me rënie të normës së arkëtitimit korrente në (-4.4%), përbën dhe pjesën kryesore në përkeqësimin e këtij treguesi pasi mbetet shoqëria UK më e madhe në sektor me rreth 36% të totalit të të ardhurave të sektorit.**

Gjithashtu, edhe Norma e Arkëtitimit e Përgjithshme në nivelin 102.4%, paraqitet e përkeqësuar me 1.1% krahasuar me vitin 2023 që ishte 103.5%. Përkeqësimi i këtij treguesi lidhet edhe me faktin se mbledhja e debive të prapambetura bëhet gjithmonë dhe më e vështirë për shkak të klientëve dhe objekteve që për arsye të ndryshme nuk ekzistojnë më, edhe pse aksionet e ndërmarra nga shoqëritë UK rajonale nën drejtimin e AKUK me task forcat përkatëse për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura nga debitorët për shlyerjen e borxheve kanë qenë aktive gjatë gjithë vitit. Shoqëritë me performancë të përkeqësuar për Normën e Përgjithshme të Arkëtitimit janë: **UK Rajonale Berat, Kukës dhe shoqëritë ekzistuese: UK Vorë dhe UK Tiranë, e cila edhe në këtë rast jep ndikimin kryesor në përkeqësimin e këtij treguesi për sektorin UK.**

Gjithsesi, në sektor ka edhe shoqëri që kanë arkëtuar më shumë debi të vjetra krahasuar me vitin 2023, si: **UK Rajonale Shkodër, Lushnje, Durrës, Fier, Gjirokastrë dhe Sarandë.** Një pasqyrë më e saktë e këtij treguesi do të jepet në Raportin e Performancës së Sektorit UK për vitin 2024 pasi të jenë bërë rakordimet me bilancet financiare të certifikuara për secilën shoqëri UK.

"Niveli i Matjes" është një tjetër tregues shumë i rëndësishëm pasi lidhet me të drejtën e konsumatorit që të faturohet me sasinë reale të ujit të konsumuar prej tyre dhe që ndihmon në një përcaktim më të saktë të treguesit të UPA. Nga ana tjetër, për konsumatorët e zonave rurale dhe atyre me shtëpi private instalimi i matësve individualë ndikon direkt në uljen e nivelit të shpërdorimit të ujit të përdorur prej tyre, kryesisht për ujitje. Niveli i Matjes për vitin 2024, rezulton 87.9% i përmirësuar me 1.4% krahasuar me vitin 2023.

Gjatë vitit 2024, në të gjithë sektorin janë instaluar rreth 33,236 matës uji më shumë krahasuar me vitin e kaluar, por ende në sektor raportohen 119,026 klientë pa matës, nga të cilët 4,514 janë të kategorisë jo familjarë. Referuar VKM nr. 96, datë 21.02.2007, klientët jo familjarë (subjektet private) janë të detyruar të instalojnë ujëmatës me shpenzimet e tyre, vendim që akoma nuk është zbatuar plotësisht nga ana e shoqërive UK për këtë kategori klientësh.

Në vijim të reformës, pajisja e të gjithë klientëve me matës duhet të jetë një nga objektivat kryesorë të shoqërive UK rajonale, si një element që përmirëson dhe lehtëson menaxhimin e kërkesës për ujë, uljes së shpërdorimeve në mënyrë që t'i jepet fund abuzimit nga klientët e papërgjegjshëm.

"Eficienca e Stafit" është një tregues që lidhet direkt me kostot e punës, të cilat së bashku me energjinë elektrike zënë pjesën kryesore ndaj totalit të kostove të operimit të shoqërisë. Ky tregues krahasohet me vitin paraardhës duke marrë në konsideratë vetëm punonjësit sipas organigramës së shoqërive UK,

pa përfshirë personelin roje të nënkontraktuar me subjektet private. Ky tregues luhet në varësi të dy variablave që janë numri i stafit të shoqërive dhe numri i lidhjeve UK.

Treguesi i Eficencës së Stafit edhe për vitin 2024 rezulton me një përmirësim të lehtë në nivelin e 4.51 punonjës për 1000 lidhje UK nga 4.56 punonjës për 1000 lidhje që ishte në vitin paraardhës. Përmirësimi i lehtë i efikasitetit të stafit për vitin 2024 vjen si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve të ujit me rreth 29,233 lidhje, pasi numri i stafit është rritur me 34 punonjës.

ERRU i kushton një rëndësi të veçantë analizës së këtij treguesi duke analizuar punonjësit sipas organigramës së shoqërisë, e cila është edhe një nga dokumentet që ERRU i kërkon shoqërive në momentin që aplikojnë për nivel të ri tarifor dhe mbi të cilën vendosen edhe objektivat e këtij treguesi.

Në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të kërkesës në plotësimin e detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së veprave me personel roje të komponentëve të sistemeve të FU dhe KUN. Në ato zona shërbimi ku numri i depove, puseve dhe stacioneve të pompimit është i madh, shoqëritë janë të detyruara që të kenë një numër të konsiderueshëm punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte, çka krijon përshtypjen e një treguesi të ulët të Eficencës së Stafit. Gjithsesi, siç është përmendur më sipër në raport nga ana e AKUK, po shikohet mundësia me investime konkrete në drejtim të ruajtjes së objekteve me kamera 24/7. Aktualisht janë në zbatim dy projekte pilot në shoqëritë rajonale UKR Durrës dhe UKR Fier. Kjo pritet që të ndikojë pozitivisht në uljen e numrit të stafit dhe sigurisht të kostove të punës si zëri kryesor në shpenzimet operative të shoqërive UK.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" shpreh mesataren e orëve të furnizimit me ujë në ditë për konsumatorët. Ky tregues shpreh cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve që ato të kenë një regjim furnizimi me ujë pa ndërprerje. Kjo garanton dhe cilësinë e ujit nga ana sanitare ndaj ndotjes eventuale nga përzierja me ujërat e ndotura në rrjetet e kanalizimeve që kalojnë pranë tyre. Faktorët kryesorë që shkaktojnë këtë vazhdimësi të ulët të kohës së furnizimit me ujë janë humbjet e ujit nga mbikonsumi i pamatur si pasojë e faturimit aforfe, nga lidhjet e paligjshme dhe nga humbjet teknike në rrjete si rezultat i gjendjes së amortizuar të tyre.

Ky tregues për 2024 është përmirësuar me rreth 1 orë/ditë konkretisht në 17.3 orë/ditë nga 16.3 orë/ditë që ishte në vitin 2023. Përmirësimi i këtij treguesi lidhet direkt me investimet e nevojshme dhe rritjen e nivelit të matjes në sektor.

Nga të gjitha shoqëritë rajonale dhe individuale që operojnë në sektor, gjatë vitit 2024 rezulton se janë 8 shoqëri UK rajonale që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë 20-24 orë/ditë si **UKR Korçë, Lezhë, Berat, Gjirokastrë, Pogradec, Shkodër, Sarandë dhe Dibër** ndërsa 4 shoqëri **UK Rajonale Durrës, Elbasan, Fier, Lushnjë** dhe shoqëria **UK Tiranë** me 13-20 orë/ditë. Pjesa tjetër e shoqërive, 4 prej tyre ofrojnë furnizimin me ujë 4-13 orë/ditë. Më keq performojnë shoqëritë UK Kamzë me 4 orë/ditë dhe UK Vorë me 8 orë/ditë, të cilat nuk janë bërë akoma shoqëri rajonale.

Riorganizimi i shoqërive UK në shoqëri rajonale ka ndikuar që shoqërive ekzistuese që ofronin furnizim me ujë 24/7 u janë bashkuar shoqëri me më pak orë furnizimi dhe mesatarja e orëve për të gjithë zonën e shërbimit të tyre ka pësuar rënie. Furnizimi me ujë të pandërprerë në 24/7 sipas raportimeve ofrohet vetëm nga shoqëria rajonale UKR Lezhë. Gjithsesi, theksohet fakti se gjatë vitit 2024 janë 11

shoqëri të cilat kanë pasur përmirësim të rritjes së orëve të furnizimit me ujë, ndërsa pjesa tjetër prej 6 shoqërive kanë mbajtur të njëjtin nivel edhe për vitin 2024. Përmirësimi i orëve të furnizimit me ujë për këto shoqëri ka ardhur kryesisht si rezultat i përfundimit të investimeve që ishin në proces pranë këtyre shoqërive dhe menaxhimit më të mirë të ujit të prodhuar.

"Mbulimi i Furnizimit me Ujë" për vitin 2024 është përmirësuar me rreth 1.9% dhe paraqitet në nivelin e 77.2% nga 75.3% që ishte në vitin 2023. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rritjes së popullsisë së shërbyer me ujë me rreth 121,222 banorë. Ndikimi kryesor ka ardhur nga shoqëritë **UK Tiranë, UK Rajonale Durrës, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër, Berat dhe Lezhë.**

Mbulimi i Furnizimit me Ujë nga shoqëritë UK është i lidhur drejtpërsëdrejti edhe me investimet e nevojshme fizike që kërkohen të kryhen në sektor për të mbuluar të ashtuquajturat "zona të bardha" të pa shërbyera më parë me shërbim të furnizimit me ujë nga shoqëritë UK ekzistuese, të cilat kanë qenë në fokus të investimeve nga shoqëritë UK përmes AKUK.

"Mbulimi me Kanalizime" vijon të ketë një trend rritës edhe për vitin 2024 me një përmirësim prej 1.4% krahasuar me vitin 2023 dhe është në nivelin e 56.2%. Përmirësimi i këtij treguesi vjen si rezultat i rritjes së popullsisë me shërbimin e KUN me rreth 97,000 banorë. Në sektor janë akoma rreth 87 mijë klientë, të cilët e realizojnë grumbullimin e ujërave të ndotura nëpërmjet gropave septike, gjë që tregon nevojën e rritjes së vëmendjes për investime në drejtim të kanalizimeve. Zgjidhja me gropë septike është zgjidhje e pranueshme për zona rurale me popullsi relativisht të ulët, por problem për to mbetet respektimi i kushteve teknike të zbatimit të tyre për të garantuar ndikim negativ që ato mund të japin për ambientin pritës.

Rritja e cilësisë së shërbimit të kanalizimeve si dhe përmirësimi i këtij treguesi është i domosdoshëm dhe lidhet me nevojën e investimeve të konsiderueshme që kërkohen për këtë qëllim. Ndër vite, niveli i investimeve në drejtim të mbulimit me KUN nuk ka qenë i mjaftueshëm, sepse në fakt investimet kanë qenë të orientuara kryesisht në drejtim të shërbimit të furnizimit me ujë.

Nga ana tjetër, duhet që fokusi i investimeve të jetë edhe në drejtim të rritjes së popullsisë së shërbyer me ITUN, bazuar edhe në kërkesat e BE-së ku Shqipëria aderon të jetë pjesë.

"Eficienca e Energjisë" është një tregues shumë i rëndësishëm i performancës financiare të shoqërive UK. Për vitin 2024, efienca e energjisë për furnizimin me ujë në sektor është 0.58 kWh/m³ nga 0.63 kWh/m³ që ishte në vitin 2023. Përmirësimi i këtij treguesi vjen kryesisht nga ulja e konsumit të kWh me 5 milionë kwh krahasuar me vitin 2023. Kjo, si rezultat i investimeve të reja në pompa si dhe i rënies së volumit të ujit të prodhuar me ngritje mekanike dhe në disa raste si rezultat i rakordimeve të bëra nga shoqëritë UK me OSHE për faturime të pasakta.

Iniciativa e nisur nga AKUK për studimin e efikasitetit të energjisë, në kuadër të programit kombëtar të modernizimit të sektorit, ku janë përcaktuar auditimet e përgjithshme të energjisë në pesë shoqëri UK rajonale si: **UKR Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan, dhe Shkodër**, të cilat përfaqësojnë 40 për qind të ngarkesës të lidhur me konsumin vjetor, duhet të shtrihet në të gjitha shoqëritë UK që operojnë në sektor.

"Ankesat e Klientëve" edhe ky një tregues shumë i rëndësishëm, i cili demonstroi nivelin e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve, si dhe mbrojtjen e interesave të tyre, lidhet direkt edhe me

angazhimin e ERRU-së në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit nga shërbime të karakterit monopol siç janë ato të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Ankesat e klientëve në raport me numrin total të lidhjeve të sektorit UK për vitin 2024 janë 3.6%, nga 4.23% që ishin në vitin 2023, me një ulje prej 5,000 ankesash për të gjithë sektorin. Përmirësimi i këtij treguesi lidhet edhe me konsolidimin e shoqërive UK rajonale gjatë vitit të dytë të operimit të tyre. Ndikimin kryesor në përmirësimin e këtij treguesi e kanë dhënë kryesisht shoqëritë **UK Rajonale Shkodër, Gjirokastrë, Fier, Berat dhe Pogradec**.

Investimet në Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve për Vitin 2024

Investimet në sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve që realizohen nëpërmjet agjencisë zbatuese AKUK ndahen në :

- I. Të financuara nga buxheti i shtetit, përkatësisht:
 - a) investime fizike në sistemet e FU dhe KUN
 - b) Investime për studim-projektim-mbikëqyrje punimesh të investimeve fizike
 - c) Kontributet lokale në zbatim të projekteve të financuara
- II. Investime të projekteve të financuara nga donatorët e huaj sipas marrëveshjeve përkatëse me qeverinë shqiptare.

Referuar të dhënave nga AKUK për vitin 2024, në total investimet sipas specifikave të mësipërme jepen në Tabelën nr. 10, ku vihet re se për vitin 2024 për investime në sektorin UK nga buxheti i shtetit dhe donatorët janë alokuar fondet në vlerën e rreth 12,969,521,000 lekë (ose rreth 129.7 milionë euro) dhe janë disbursuar 12,653,394,674 lekë (ose rreth 126.5 milionë euro), pra rreth 98% të planifikuara.

Nga totali i investimeve prej 12,653,394,674 lekë, janë financuar nga Qeveria Shqiptare 11,179,835,619 lekë (ose rreth 99% të totalit), si edhe 1,473,559,055 lekë nga donatorët e huaj (rreth 12% të totalit).

Pjesa më e madhe e financimit në vitin 2024 ka qenë për objektet në vazhdim 8.577 miliardë lekë (rreth 85.7 milionë euro) dhe vetëm 1.988 miliardë lekë (rreth 19.8 milionë euro) janë financuar për objekte të reja me financim të brendshëm nga buxheti i shtetit.

Investimet me financime të huaja kanë qenë kryesisht nga KfW në vazhdimësi të Programit të Infrastrukturës Bashkiake IV dhe V, Banka Botërore dhe SIDA, nga të cilat është disbursuar (89%) e vlerës së fondit të planifikuar. Vlera e disbursuar nga investimet e huaja ka qenë vetëm për objektet në vazhdim.

Theksohet fakti se investimet fizike janë të orientuara drejt reformimit të sektorit UK në përmbushje të Strategjisë Kombëtare në plotësim të nevojave të një ekonomie në zhvillim. Në tabelën nr.8, jepen të detajuara zërat e buxhetit, të planifikuara dhe të disbursuar për vitin 2024, sipas objekteve në proces dhe ato të reja.

Tabela Nr.10 Financimi i projekteve në vazhdim dhe të reja nga AKUK dhe burimet e huaja Viti 2024

Përshkrimi	Vlera e Planifikuar	Vlera e Financuar	Realizimi
	(në lekë)	(në lekë)	(në %)
Investimet nga AKUM	11,309,982,000	11,179,835,619	99
I. Objektet në vazhdim me financim të brendshëm	8,658,288,677	8,577,121,472	99
a) Objektet e reja të vitit 2024 me financim të brendshëm	2,026,589,910	1,988,725,384	98
b) Supërvizim punimesh	137,885,489	127,087,887	92
TVSH	321,177,278	320,960,230	100
c) Kosto Lokale	166,040,646	165,940,646	100
II. Investimet e Huaja (Objekte në vazhdim)	1,659,539,000	1,473,559,055	89
TOTALI	12,969,521,000	12,653,394,674	98
	(eq.129.7 mln euro)*	(eq.126.5 mln euro)*	

Burimi: AKUK

* 1 euro = 100 lekë

Një informacion më i detajuar me emërtime të objekteve dhe vlera mbi investimet e realizuara në sektorin UK për vitin 2024 do të jepet në raportin e veçantë të performancës së sektorit UK, i cili publikohet në fund të muajit qershor 2025. ERRU e paraqet atë në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave pasi ka marrë të dhëna të certifikuara nga të gjitha shoqëritë UK.

Subvencionet për vitin 2024

Për vitin 2024, qeveria qendrore ka shpërndarë subvencione në vlerën e 349 milionë lekëve, për të gjitha shoqëritë UK rajonale, 14 të krijuara deri më tani, si dhe për dy shoqëri UK ekzistuese si: UK Tiranë dhe UK Vorë.

Shpërndarja e subvencioneve për vitin 2024 është realizuar referuar udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.2, datë 26.03.2024 “Për Miratimin e Metodologjisë për Kriteret dhe Procedurat për Shpërndarjen dhe Përdorimin e Subvencioneve Shtetërore për Ofruesit e Shërbimeve në Sektorin e UK për vitin buxhetor 2024”.

Referuar këtij udhëzimi, në pikën 6 (a) citohet se shoqëritë rajonale ose jo e përdorin fondin e subvencionit për të akorduar çdo muaj, përmes një zbritjeje 100% në shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të kategorive të përcaktuara në pikën 3 të kësaj metodologjie, kategoritë në nevojë që përfitojnë nga kompensimi për konsumin e sasisë minimale jetike të ujit të pijshëm, deri në masën 5m³/muaj. Vlera e përfituar për shtresat në nevojë që është zbatuar për 14 shoqëritë UK rajonale dhe për dy shoqëritë: UK Tiranë dhe UK Vorë është vetëm 30 milionë lekë.

Në pikën 6 (b), të po këtij vendimi, citohet se pjesa e mbetur e fondit të subvencionit do të përdoret për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për shoqëritë që e kanë mbi 75% të prodhimit me ngritje mekanike, kriter i cili është zbatuar për të subvencionuar shoqëritë: UKR Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Shkodër dhe Vlorë.

Referuar vlerës totale të subvencioneve për vitin 2024 rezulton se 91.2% janë shpërndarë për kostot e energjisë elektrike dhe vetëm 8.8% janë shpërndarë për shtresat në nevojë.

Shpërndarja e subvencioneve në detaje për vitin paraardhës 2023 dhe vitin 2024 sipas zërave të mësipërm në përqindje jepet në tabelën 11, ndërsa në Aneks 3 jepet e detajuar shpërndarja e subvencioneve për vitin 2023 dhe 2024 për secilën shoqëri rajonale UK.

Tabela Nr.11. Shpërndarja e subvencioneve për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023.

Shpërndarja e Subvencioneve	Viti 2023 Shpërndarja		Viti 2024 Shpërndarja	
	(në Lekë)	(në %)	(në Lekë)	(në %)
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	14,288,043	4.6		
Tatim Taksa të papaguara	170,684	0.1		
Paga të papaguara	14,091,049	4.5		
Energji Elektrike	281,450,224	90.8	319,028,019	91.2
Shtresat në Nevojë			30,865,624	8.8
Totali	310,000,000	100	349,893,643	100

Referuar shpërndarjes së subvencioneve vlen të theksohet se për shoqëritë, të cilat nuk e kanë përfunduar procesin e rajonalizimit të parashikuara sipas VKM nr. 302, përkatësisht: *UK Tiranë, UK Kamzë dhe UK Vorë*, të cilat pritet të rajonalizohen si Shoqëria Rajonale UK Tiranë, nuk janë shpërndarë subvencione për mbulimin e kostove të energjisë, por vetëm për subvencionimin e 5m³/muaj të konsumatorëve të kategorizuar si shtresa në nevojë. Kjo lidhet edhe me strategjinë e qeverisë qendrore, e cila i ka dhënë prioritet me mbështetje financiare shoqërive UK që janë bërë pjesë e reformës sipas VKM nr. 302 ku MIE/AKUK është aksionare me 51% të aksioneve.

7 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe të Sektorit të Ujit

- Të planifikohen investime të dedikuara dhe të alokohen fondet përkatëse nga AKUK për pajisjen e të gjithë sistemeve të FU me ujëmatës të mëdhenj në burim dhe tek konsumatorët në mënyrë që shoqëritë UK të kenë mundësinë e vlerësimit dhe reduktimit të humbjeve, evidentimit të gjendjes reale të kërkesës për ujë dhe mbrojtjen e burimeve.
- Të hartohen nga shoqëritë rajonale UK “Planet e Menaxhimit të Aseteve” për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e asetëve që mund të përmirësojë efikasitetin në mënyrën se si administrohen asetet si dhe uljen e kostove të mirëmbajtjes.
- Në përgjigje të ndryshimeve të shpejta të kushteve klimatike dhe zhvillimit të teknologjisë dhe industrisë në fushën e ujit, në bashkëpunim me AKUK, të hartohen planet afatshkurtër dhe afatgjatë të investimeve në infrastrukturën aktuale të sistemeve FU dhe KUN.
- Të vijojë procesi i rishikimit dhe miratimit të kuadrit të ri ligjor rregullator në sektorin e ujit sipas zhvillimeve që ka pësuar sektori dhe rregullimi sipas standardeve dhe direktivave evropiane për ujin e pijshëm dhe largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura.
- Duke patur parasysh që një pjesë të mirë të kostove të justifikuara që duhet të mbulohen me tarifa e përbëjnë investimet e reja, duhet të krijohet mundësia që ERRU të përfaqësohet për të dhënë rekomandimet e saj në komisionet teknike pranë AKUK për aprovimin e projekteve të reja për investime.

Aneks 1 - Aplikimet e Shoqërive dhe Situata e Licencimit për Vitin 2024

Tabela 1. Aplikimet e shoqërive që kanë kaluar për vendimmarrje

Nr.	Shoqëritë që kanë aplikuar	Kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR					
		Mbarim afati	Ndryshim Drejtuesi Ligjor	Ndryshim Drejtuesi Teknik	Ndryshim Zone Shërbimi	Licencim për herë të parë si SKP	Shtim kategori shërbim
1	Sh.R UK Shkodër		X				
2	Sh.R UK Durrës		X	X			
3	Sh.R UK Kukës		X				
4	Sh.R UK Durrës			X			
5	Sh.R UK Vlorë					X	
6	Sh.R UK Korçë	X					
7	Sh.A UK Tiranë		X				
8	Sh.A UK Vorë	X					
	Totali				8		

Burimi: ERRU

** UK Rajonale Durrës ka aplikuar dy herë gjatë vitit 2024*

Tabela 2. Situata e Licencimit të Shoqërive UK për Vitin 2024

Nr.	Operatorët	Mbarimi i afatit të licencimit	Licencimi
1	Fier UK Rajonale	02.03.2025	Me licencë
2	Lezhë UK Rajonale	01.12.2026	Me licencë
3	Kukës UK Rajonale	29.01.2027	Me licencë
4	Durrës UK Rajonale	21.02.2027	Me licencë
5	Gjirokastrë UK Rajonale	21.02.2027	Me licencë
6	Berat UK Rajonale	02.03.2027	Me licencë
7	Lushnje UK Rajonale	02.03.2027	Me licencë
8	Elbasan UK Rajonale	27.04.2027	Me licencë
9	Sarandë UK Rajonale	27.04.2027	Me licencë
10	Pogradec UK Rajonale	27.04.2027	Me licencë
11	Dibër UK Rajonale	22.06.2027	Me licencë
12	Shkodër UK Rajonale	26.12.2027	Me licencë
13	Tiranë UK	21.02.2027	Me licencë
14	Kamzë UK	27.02.2026	Me licencë
15	Vlorë UK	07.11.2028	Me licencë
16	Korçë UK Rajonale	19.12.2028	Me licencë
17	Vorë UK	19.12.2028	Me licencë

Burimi: ERRU

Aneks 2 - Tarifat për Shërbimin e FU dhe Largimit të UN - Viti 2024

Nr.	Emri i shoqërisë rajonale	Data e hyrjes në fuqi të vendimit	2024								
			Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm			Shërbimi i largimit të ujërave të ndotur			Tarifë fikse		
			Tarifë variabël			Tarifa variabël					
Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat			
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a											
1	Njësia Korçë	01.01.2018	72/38/28*	117/110*	140/100*	42	64	64	140	140	140
	Njësia Devoll	01.01.2012	38	100	110				50	50	50
	Njësia Maliq	01.03.2018	45/22.5*	100	105				54/50 /27*	54/50 *	54/50 *
	Njësia Pustec										
	Njësia Kolonjë	01.04.2015	38	100	110	10	13	18	100	100	100
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec sha											
2	Njësia Pogradec	10.08.2024	65/35*	120/100*	120/100*	35/25*	50/40*	50/40*	200	300	300
	Njësia Përrenjas	10.08.2024	45/35*	100/70*	100/70*	25	40	40	200	300	300
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a											
3	Njësia Durrës	15.06.2024	70	140	140	50	70	70	200	300	300
	Njësia Shijak	15.06.2024	70	140	140	50	70	70	200	300	300
	Njësia Kavajë	15.06.2024	50	140	140	30	50	50	200	300	300
	Njësia Krujë	15.06.2024	48	96	100	10	20	20	200	300	300
	Njësia Rrogozhinë	15.06.2024	48	96	100	10	20	20	200	300	300
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë sh.a											
4	Njësia Lezhë	05.04.2024	65	135	145	19	25	29	200	400	400
	Njësia Kurbin	05.04.2024	45	80	120	15	25	25	100	200	200
	Njësia Rrëshen	05.04.2024	45	100	115	15	25	25	100	200	200
	Njësia Rubik	05.04.2024	45	70	100	15	25	25	100	200	200
Shoqëria Rajonale Kanalizime Ujësjellës Dibër sh.a											
5	Njësia Dibër	01.01.2010	27	65	85						
	Njësia Bulqizë	01.10.2022	25	75/55*	83.3	10	17	17	100	100	100
	Njësia Mat	01.01.2006	23	60	80	2	4	6			
	Njësia Klos										
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a											
6	Njësia Kukës	01.10.2022	30	80	100	10	20	30	50	100	100
	Njësia Tropojë	01.08.2019	30/40	80	80	13	22	22	100	100	100
	Njësia Has										
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a											
7	Njësia Elbasan	01.01.2023	40	130	130	9	30	30	200	400	400
	Njësia Librazhd	01.12.2018	42/26	100/60	100	15	25	26	100	100	100
	Njësia Gramsh	01.06.2018	32	90	90				60	150	180
	Njësia Cërrik										
	Njësia Belsh										
	Njësia Peqin	01.12.2020	48	120	120	12	16	16	100	200	200
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a											
8	Njësia Fier	18.05.2024	60	115	125	20	20	20	200	200	200
	Njësia Patos	18.05.2024	70	135	135	20	20	20	200	200	200
	Njësia Mallakastër	18.05.2024	60	115	125	20	20	20	200	200	200
	Njësia Roskovec	18.05.2024	60	115	125	20	20	20	200	200	200
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë sh.a											
9	Njësia Gjirokastrë	01.01.2025	50/30*	133/60*	138/60*	15	20	20	200	300	300
	Njësia Tepelenë	01.01.2025	50	100	120	15	20	20	200	400	300
	Njësia Këlcyrë	01.01.2025	50	100	100	15	20	20	200	300	300
	Njësia Përmet	01.01.2025	50/30*	110/60*	120/60*	15	20	20	200	300	300
	Njësia Libohovë	01.01.2025	30	70	90	15	20	20	200	300	300
	Njësia Dropull	01.01.2025	30	60	60				200	300	300
	Njësia Memaliaj	01.01.2025	50	100	120	15	20	20	200	400	300
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje sh.a											
10	Njësia Lushnjë	01.10.2019	62	130/110*	130/110*	17	21	24	100	200/100*	200/100*
	Njësia Divjakë										
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a											
11	Njësia Berat	01.11.2019	50/40*	130	130	14	24	24	100	200	200
	Njësia Kuçovë	01.11.2019	50	130	130	14	24	24	100	200	200
	Njësia Dimal										
	Njësia Skrapar	01.06.2018	35	100	110	10	10	10	100	100	100
	Njësia Poliçan	01.04.2019	50	100	110	12	15	15	100	100	100
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a											
12	Njësia Sarandë	01.07.2021	60	140	140	25	45	45	200	200	200
	Njësia Finiq										
	Njësia Konispol	01.10.2022	50/66.7*	83.3	83.3						
	Njësia Delvinë	01.05.2019	58	120	120	18	35	35	167	200	200
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a											
13	Njësia Shkodër	01.01.2025	55	110	110	30	40	40	200	300	300
	Njësia Fushë Arrëz	01.01.2025	40	80	80	20	20	20	200	300	300
	Njësia Pukë	01.01.2025	40	130	140	20	20	20	200	300	300
	Njësia Vau Dejës	01.01.2025	55	120	120	20	30	30	200	300	300
	Njësia Malësi e Madhe	01.01.2025	55	120	120	20	30	30	200	300	300
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a											
14	Njësia Vlorë	01.02.2024	60	120	120	17	28	28	200	400	400
	Njësia Selenicë	01.07.2010	30	80	100						
	Njësia Himarë	01.12.2019	55	100	100	30	50	50	200	200	300
15	UK Tiranë	01.01.2018	65	140	155	11	30	35	200	200	200
16	UK Kamzë										
17	UK Vorë	01.02.2020	65	140	155	15	30	35	200	200	200

Burimi: ERRU

Shoqëritë që nuk kanë tarifa të miratuara nga ERRU

* Tarifa fikse të ndara për ujë dhe kanalizime

** Tarifa të ndryshme për qytetin dhe zonën rurale

Aneks 3 - Subvencionet e Shoqërive UK, Vitet 2023-2024 (në lekë)

Nr.	Emri i shoqërisë rajonale	Subvencionet 2023					Subvencionet 2024		
		Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	Tatim Taksa	Paga të papaguara	Energji Elektrike	Totali 2023	Vlera e përfituar për shtresat ne nevojë	Vlera për detyrime të energjisë elektrike	Totali 2024
1	Sh R UK Korçë					-	6,300,044		6,300,044
	Njësia Korçë						3,934,412.9		
	Njësia Devoll						570,528.1		
	Njësia Maliq						1,467,205		
	Njësia Pustec						105,420.0		
2	Njësia Kolonjë						222,477.4		
	Sh R UK Pogradec						8,626,699		8,626,699
	Njësia Pogradec						6,372,767.4		
	Njësia Prrrenjas						2,253,931.2		
	Sh R UK Durrës				104,604,254	104,604,254	26,351	75,000,000	75,026,351
3	Njësia Durrës								
	Njësia Kavajë								
	Njësia Shijak								
	Njësia Krujë						20,224.8		
	Njësia Rrogozhinë						6,126.0		
4	Sh R UK Lezhë	-	-	-	47,992,330	47,992,330	1,412,476		1,412,476
	Njësia Lezhë						848,338.0		
	Njësia Mirditë						246,606.0		
	Njësia Kurbini						317,532.0		
	Sh R UK Dibër						2,493,684		2,493,684
5	Njësia Dibër						1,105,711.4		
	Njësia Bulqizë						534,550.0		
	Njësia Mat						496,523.1		
	Njësia Klos						356,900.0		
	Sh R UK Kukës						3,078,055		3,078,055
6	Njësia Kukës						2,214,714.0		
	Njësia Tropojë						732,511.2		
	Njësia Has						130,830.0		
	Sh R UK Elbasan				68,489,900	68,489,900	2,268,456	50,000,000	52,268,456
	Njësia Elbasan						1,148,340.4		
7	Njësia Librazhd						240,014.0		
	Njësia Gramsh						189,440.2		
	Njësia Cërrik						251,014.4		
	Njësia Belsh						367,531.2		
	Njësia Peqin						72,115.8		
8	Sh R UK Fier				28,913,516	28,913,516	1,701,667	45,000,000	46,701,667
	Njësia Fier						943,087.0		
	Njësia Patos						228,324.0		
	Njësia Mallakastër						379,776.0		
	Njësia Roskovec						150,480.0		
9	Sh R UK Gjirokastrë						786,988		786,988
	Njësia Gjirokastrë						202,318.8		
	Njësia Tepelenë						116,226.5		
	Njësia Këlcyre						183,171.0		
	Njësia Përmet						99,703.0		
10	Njësia Libohovë						8,571.5		
	Njësia Dropull						55,902.5		
	Njësia Memaliaj						121,095.0		
	Sh R UK Lushnjë						495,878		495,878
	Njësia Lushnjë						495,878		
11	Njësia Divjakë								
	Sh R UK Berat						902,250	17,000,000	17,902,250
	Njësia Berat						366,556.8		
	Njësia Kuçovë						118,181.0		
	Njësia Dimal						60,630.0		
12	Njësia Skrapar						152,436.0		
	Njësia Poliçan						204,446.6		
	Sh R UK Sarandë						796,044		796,044
	Njësia Sarandë						238,358.0		
	Njësia Finiq						36,686.0		
13	Njësia Konispol						126,592.0		
	Njësia Delvinë						394,408.0		
	Sh R UK Shkodër	9,277,839			20,722,161	30,000,000	1,208,055	60,000,000	61,208,055
	Njësia Shkodër						217,818.0		
	Njësia Fushë Arrëz						20,535.0		
14	Njësia Pukë						83,185.2		
	Njësia Vau Dejës						419,266.8		
	Njësia Malësi e Madhe						467,249.8		
	Sh R UK Vlorë	5,010,204	170,684	14,091,049	10,728,063	30,000,000	114,489	72,028,019	72,142,508
	Njësia Vlorë						66,314.0		
15	Njësia Selenicë						46,729.0		
	Njësia Himarë						1,446.0		
	Shoqëria UK Tiranë						604,568.0		604,568
	Shoqëria UK Kamëz								
	Shoqëria UK Vorë						49,920.0		49,920
Totali		14,288,043	170,684	14,091,049	281,450,224	310,000,000	30,865,624	319,028,019	349,893,643
Shpërndarja në % sipas qëllimit		4.6%	0.1%	4.5%	90.8%	100.0%	8.8%	91.2%	100.0%

Burimi: AKUK

Aneks 4 - Mbledhjet dhe Vendimet e KKRR - Viti 2024

Nr.	Data e mbledhjes	Vendime
1	10.01.2024	Vendim për detajimin e planit të shpenzimeve operative të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2024
2	10.01.2024	Vendim për miratimin e Programit Vjetor të shërbimeve jashtë vendit të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2024
3	05.02.2024	Vendim për miratimin e Raportit Vjetor të veprimtarisë së ERRU-së për vitin 2023
4	05.02.2024	Vendim për caktimin e zëvendëskryetarit Znj. E. Braha
5	06.03.2024	Vendim për ndryshim të drejtuesit ligjor për shoqërinë Rajonale UK Shkodër
6	06.03.2024	Vendim për shpalljen e njoftimit për vend vakant në pozicionin Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUN dhe ITUN
7	06.03.2024	Vendim për miratimin e nivelit të ri tarifar për shoqërinë rajonale UK Lezhë
8	06.03.2024	Vendim për vijimin e marrëdhënieve të punës për Znj. H. Ismaili
9	06.03.2024	Vendim për vijimin e marrëdhënieve të punës për Znj. N. Salu
10	06.03.2024	Vendim për veprimtarin sociale për Znj. M. Konçi
11	04.04.2024	Vendim për emërimin në detyrë të Znj. L. Sinani në pozicionin Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUN dhe ITUN
12	18.04.2024	Vendim për miratimin e nivelit të ri tarifar për shoqërinë Rajonale UK Fier
13	16.05.2024	Vendim për ndryshim të drejtuesit ligjor dhe teknik për shoqërinë rajonale UK Durrës
14	16.05.2024	Vendim për miratimin e nivelit të ri tarifar për shoqërinë rajonale UK Durrës
15	16.05.2024	Vendim për fillim procedure për aplikimin për nivel të ri tarifar për shoqërinë Rajonale UK Pogradec
16	21.06.2024	Vendim për miratimin e dorëheqjes për Z. K. Shyti në pozicionin specialist IT.
17	24.06.2024	Vendim për caktimin e Znj. F. Imeraj si nëpunës autorizues i Entit Rregullator të Ujit.
18	24.06.2024	Vendim për autorizimin e Znj. F. Imeraj mbi nënshkrimin e çdo komunikimi zyrtar në rrugë shkresore të ERRU-së.
19	09.07.2024	Vendim për fillim procedure për nivel të ri tarifar për shoqërinë rajonale UK Gjirokastrë
20	09.07.2024	Vendim për miratimin e nivelit të ri tarifar për shoqërinë rajonale UK Pogradec
21	09.07.2024	Vendim për miratimin e raportit të performancës për shoqëritë UK për vitin 2023
22	09.07.2024	Vendim për vijimin e marrëdhënieve të punës për Znj. L. Sinani
23	20.08.2024	Vendim për shpallje vend vakant pozicioni i punës specialist IT
24	12.09.2024	Vendim për disa ndryshime në rregulloren për rekrutim, vlerësim dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës
25	12.09.2024	Vendim për fillim procedure për aplikimin të nivelit të ri tarifar për shoqërinë rajonale UK Shkodër
26	12.09.2024	Vendim për fillim procedure për aplikimin për nivel të ri tarifar për shoqërinë rajonale UK Korçë
27	12.09.2024	Vendim për shpalljen fituese në pozicionin e specialistit të IT për Znj. A. Meçaj
28	12.09.2024	Vendim për shpalljen e vendit vakant në pozicionin e specialist juridik.
29	23.09.2024	Vendim për miratimin e strategjisë institucionale të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2025-2027
30	23.09.2024	Vendim për caktimin e zëvendëskryetarit për Znj. E. Shurdha
31	23.09.2024	Vendim për ndryshimin e drejtuesit teknik për shoqërinë rajonale UK Durrës
32	30.09.2024	Vendim për miratimin e buxhetit për vitin 2025
33	07.10.2024	Vendim për emërimin në detyrë në pozicionin e specialist juridik për Znj. J. Ballo
34	07.10.2024	Vendim për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore vjetore
35	07.10.2024	Vendim për miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2025-2027
36	07.10.2024	Vendim për ngritjen e grupit të Menaxhimit Strategjik Institucionalë për vitin 2025-2027
37	07.10.2024	Vendim për ngritjen e grupit të menaxhimit të riskut për vitin 2025-2027
38	23.10.2024	Vendim për një ndryshim në metodologjinë e tarifave të shërbimeve UK
39	23.10.2024	Vendim për fillimin e procedurës për nivel të ri tarifar për Shoqërinë Rajonale UK Berat
40	23.10.2024	Vendim për fillimin e procedurës për nivel të ri tarifar për shoqërinë Rajonale UK Elbasan
41	23.10.2024	Vendim për ndryshim të drejtuesit ligjor për shoqërinë rajonale UK Kukës
42	08.11.2024	Vendim për licencimin e shoqërisë rajonale UK Vlorë
43	08.11.2024	Vendim për dhënie ndihme në rast fatkeqësie për Z. K. Leskaj
44	08.11.2024	Vendim për miratimin e raportit të bilancit të ujit për shoqëritë UK për vitin 2023
45	02.12.2024	Vendim për miratimin e nivelit të ri tarifar për shoqërinë rajonale UK Shkodër
46	02.12.2024	Vendim për miratimin e nivelit të ri tarifar për shoqërinë rajonale UK Gjirokastrë
47	02.12.2024	Vendim për një ndryshim në detajimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU-së për vitin 2024
48	02.12.2024	Vendimin për shpërblimin vjetor të Sekretarit të Përgjithshëm
49	02.12.2024	Vendim për vijimin e marrëdhënieve të punës për Znj. A. Mecaj, si specialist IT
50	02.12.2024	Vendim për vijimin e marrëdhënieve të punës për Znj. A. Kapaj
51	20.12.2024	Vendim për licencimin e shoqërisë rajonale UK Korçë
52	20.12.2024	Vendim për një ndryshim të drejtuesit ligjor për shoqërinë UK Tiranë
53	20.12.2024	Vendim për rinovim licence për Shoqërinë UK Vorë
		53 VENDIME KKRR

Aneks 5 - Referencat Ligjore të Aktivitetit të ERRU-së

- Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102);
- Ligji nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” (ligji nr. 120/2016);
- Ligji nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” (ligji nr. 111/2012);
- Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar (ligji nr. 9902);
- Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121);
- Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (Kodi i Procedurave Administrative);
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Kodi i Punës);
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (ligji nr. 10296);
- Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar (ligji nr. 9584);
- Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” (ligji nr. 8480);
- Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (ligji nr. 119/2014);
- Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar (ligji nr. 139/2015);
- VKM nr. 958, datë 6.5.2009 “Për Miratimin e Kategorive të Licencimit dhe Procedurave të Aplikimit për Licencë të Operatorëve që Ushtrjnë Veprimtarinë në Sistemet e Furnizimit me Ujë, të Largimit dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotura” (VKM nr. 958);
- VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe kanalizime në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizime sh.a.” (Kodi i Ujit);
- VKM nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63);
- VKM nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” (VKM nr. 302);
- VKM nr. 448, datë 26.7.2023, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2023–2030” (VKM nr. 448);
- VKM nr. 326, datë 29.05.2024, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut 2024–2030” (VKM nr. 326);
- Vendim i Kuvendit nr. 33/2022, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU);
- Vendimi i KKRR nr. 29, datë 08.12.2009, i ndryshuar “Për Procedurat e Dhënies dhe Rinovimit të Licencave Profesionale për Subjektet Juridike e Fizike që Ushtrjnë Veprimtari në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, (Rregullore e licencimit);

- Vendimi i KKRR nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, i ndryshuar (Metodologjia e Tarifave);
- Vendimi i KKRR nr. 420, datë, 29.09.2022 “Për licencat dhe tarifat e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta”;
- Vendim i KKRR nr. 30, datë 23.09.2024, “Për miratimin e Strategjisë Institucionale të Entit Rregullator të Ujit 2025 – 2027”;
- Vendim i KKRR nr. 35, datë 07.10.2024, “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore vjetore”.